

## GJYKATA E QARKUT E PRISHTINËS

P Nr. 462/09

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut e Prishtinës, trupi gjykues i përbërë nga:

Gjykatësi i EULEX, Z. Ferdinando Buatier de Mongeot, Kryetar i Trupit Gjykues Gjykatës  
Gjykatës i EULEX, Z. Francesco Florit, Anëtar i Trupit Gjykues  
Gjykatësi Vendor, Z. Nehat Idrizi, Anëtar i Trupit Gjykues

Të ndihmuar nga procesmbajtësi Christin Nilsson, në lëndën penale kundër:

**OVE JOHANSEN**, shtetas i Norvegjisë, data e lindjes 4 dhjetor 1962, vendi i lindjes Kristiansand, Norway, banor i Podgoricës, Mali i Zi, aktualisht në paraburgim në Qendër për Paraburgim në Prishtinë që nga 09 korriku 2009,

Sipas Aktakuzës së Zyrës së Prokurorit Special të datës 4 nëntor 2009 për shkak të veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare, në bashkëkryerje nga nenet 339 paragrafi 3 lidhur me nenin 23 të KPK, ku dobia materiale tejkalon 5000 Euro, e dënueshme me burgim deri në tetë vjet, dikur neni 210 paragrafi 4 i Ligjit Penal të Kosovës (LPK) dënueshme me një deri në dhjetë vjet kur dobia materiale tejkalon 30.000 dinarë në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (bashkëpjesëmarrje)

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më 15<sup>h</sup>, 27 dhe 29 prill, 07 maj, 28 dhe 29 qershor dhe 06 korrik 2010, në praninë e Prokurorit Publik Special të EULEX-it Z. Joachim Stollberg dhe të Prokurorit Publik Special të Kosovës Z. Faik Halili, të akuzuarit dhe Avokatit të tij Mbrojtës Z. Betim Shala, pas këshillimit të trupit gjykues, publikisht shpallë si në vijim:

### AKTGJYKIMI

OVE JOHANSEN është gjetur të jetë fajtor për veprë penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare në bashkë-kryerje, sikur që përshkruhet në nenin 339 paragrafin 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK dhe nenin 23 të KPK, sepse:

*Në mes të korrikut 2002 deri në mars 2003, në Prishtinë, Ove Johansen ka vepruar si përfaqësues i Norway Invest ReO AS dhe si de facto menaxher i kompanisë së vendosur në Kosovë Company Norway*

*Invest, në lidhje me "Norway Invest R&O AS", që kishte qëllimin të krijtojë dhe implementojë një rrjetë digjitale të quajtur TETRA në partnership me PTK. Gjatë periudhës në mes të janarit dhe marsit 2003 Ove Johansen, në rolin e tij të përshkruar më lart dhe në bashkë-krerje me Leme Xhema, Mustaf Neziri, Roger Reynolds dhe Ronny Sorensen, me qëllim që të përfitojë një dobi materiale të paligjshme për vete ose për Company Norway Invest, ka kontribuar në mënyrë qenësore në sjellje kriminale të Leme Xhemës, e cila ka shpërdorur pozitën e saj zyrtare si Drejtoreshë e Përgjithshme e PTK duke lëshuar një urdhër pagesë të paligjshme për 300.000,00 Euro në llogarinë bankare të Company Norway Invest. Ove Johansen ka bërë këtë duke marrë pjesë në aranzhimet e domosdoshme paraprake dhe duke faturuar pagesën e tillë të paligjshme, si dhe duke lëshuar në vazhdim një faturë të paarsyetuar të etiketuar për një kompani jo ekzistuese "ARTET". Për veprimet e saja, Leme Xhema tashmë është dënuar me një dënim të plotfuqishëm. Transferimi i tillë ka shkaktuar një humbje prej 300.000 Euros për PTK dhe i përgjigjet fitimit financiar të përfituesit të pagesës.*

Prandaj, në bazë të nenit 339, paragrafit 1 dhe 3 dhe 66 paragrafit 1 n. 2) KPK, OVE JOHANSEN dënohet me dy vjet burgim për shkak të veprës penale të përshkruar më lart. Në bazë të nenit 41, paragrafit 1 pikës 1, 42, 43 dhe 44(1),(2),(3) të Kodit Penal të Kosovës dënimi kundër Ove Johansen bëhet me kusht;

Dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk e kryen ndonjë veprë penale tjetër gjatë një periudhë prej tre viteve;

Dënimi do të ekzekutohet nëse brenda periudhës kohore prej dy viteve duke filluar prej datës kur Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm nëse Ove Johansen nuk e kompenson dëmin e shkaktuar ndaj PTK-ës në një shumë prej 300.000 Eurove;

Në bazë të nenit 73 të KPK, koha e kaluar në paraburgim prej datës së 09 korrikut 2009 gjerë më tani dhe koha e kaluar në paraburgim në Republikën e Malit të Zi prej 05 prillit 2007 gjerë më 26 prill 2007 do të përfshihet në gjatësinë e dënimit.

Në bazë të nenit 102 paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) Ove Johansen do të paguaj shpenzimet e procedurës. Dispozitat e nenit 100 paragrafit 2 të KPPK do të përpilohen dhe do të lëshohet një vendim i posaçëm mbi shumën e përgjithshme të shpenzimeve.

Në bazë të nenit 393.2.4 KPPK, paraburgimi kundër Ove Johansen anulohet dhe urdhërohet lirimi i tij i menjëhershëm sipas vendimit të bashkangjitur.

## ARSYETIMI

## 1. Historia procedurale

Më 04 nëntor 2009, Prokurori Publik ka ngritur aktakuzën (PPS no.12/09) pranë Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kundër Ove Johansen, për shkak të veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare në kundërshtim me nenin 339 paragrafi 3, e dënueshme me burgim deri në tetë vjet, ku dobia materiale tejkalon 5000 Euro, lidhur me nenin 23 të KPPK (në bashkë-kryerje), dikur neni 210 paragrafi 4 i Ligjit Penal të Kosovës (LPK) dënueshme me një deri në dhjetë vjet të burgimit kur dobia materiale tejkalon 30.000 dinarë në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (bashkëpjesëmarrje).

Dy të bashkë-pandehurit të Ove Johansen (R. S. dhe R. R.) nuk kanë mundur të kontaktohen nga Prokurori, duke qenë në arrati, dhe kështu procedura kundër tyre është ndërprerë.

Më 24 shkurt 2010 Gjykatësi Konfirmues i EULEX-it për Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, pas zhvillimit të seancës së konfirmimit ka konfirmuar aktakuzën në tërësi..

Më 26 mars 2010 Gjykatësi i EULEX-it - Kryetar i trupit gjykues ka lëshuar urdhrin për bërjen e orarit të gjykimit/shqyrtimit kryesor.

Trupi gjykues ka qenë i përbërë nga: Gjykatësi i EULEX-it Kryetar Ferdinando Buatier de Mongeot, Gjykatësi i EULEX-it Francesco Florit dhe Gjykatësja Vendore Marie Ademi si anëtarë të trupit gjykues. Seanca e shqyrtimit kryesor ka filluar më 15 prill 2010.

Nuk janë ngritur kundërshtimet nga palët lidhur me përbërjen e Trupit Gjykues.

Aktakuza është lexuar nga Prokurori Publik dhe i akuzuari është deklaruar se nuk është fajtor.

Më 27 prill 2010 Gjykata ka dëgjuar dëshminë e dëshmitares L. Xh..

Më 29 prill 2009, Gjykata ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve M. N. dhe E. T..

Më 07 maj 2010 trupi gjykues dhe palët u pajtuan mbi hapat që do të merren lidhur me kërkesën për ndihmën ndërkombëtare ligjore nga Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Italisë dhe Republika e Malit të Zi.

Në vazhdim, Trupi Gjykues ka kërkuar nëpërmes të kanaleve diplomatike ndihmën ligjore ndërkombëtare nga Mbretëria e Norvegjisë për seancë dëgjimore nëpërmes të video konferencës të dëshmitarëve T. M. dhe R. S. Trupi Gjykues ka kërkuar gjithashtu nga Republika e Italisë, nëpërmes të kanaleve diplomatike, që të thirret dëshmitari M. D. T.(shtetas Italian dhe dikur hetues i FIU/NjFI i UNMIK-ut) për seancën dëgjimore të 29 qershorit 2010. Në fund Trupi Gjykues ka kërkuar nga Republika e Malit të Zi informata lidhur me periudhën e kaluar në paraburgim nga ana e Ove Johansen në Mal të Zi.

Më 28 qershor 2010 Gjykata ka ekzaminuar nëpërmes të video konferencës me Gjykatën e Qarkut të Oslos dëshmitarët R. S. dhe T. E.

Më 29 qershor 2010 Gjykata ka dëgjuar dëshminë e Z. M. D. T.

Më 06 korrik 2010, trupi gjykues ka ndërruar përbërjen e vet, pasi që ka qenë i informuar se Gjykatësja vendore Maria Ademi në ndërkohë ka shkuar në Gjykatën Supreme.

Trupi i ri gjykues përbëhej nga: Ferdinando Buatier de Mongeot Gjykatës si Kryetar, Francesco Florit dhe Gjykatësi vendor Nehat Idrizi si anëtarë të trupit gjykues. Nuk ka pasur vërejtje të ngritura nga palët lidhur me përbërjen e re të Trupit Gjykues.

Pas shpalljes së Trupit të ri Gjykues, Gjykata ka rifilluar tërë procedurën prej fillimit.

Me rëndësi është se palët kanë propozuar si provë në gjykimin e ri vetëm dëshmitarët të cilët aktualisht kanë qenë të ekzaminuar gjatë shqyrtimit kryesor të mëparshëm dhe u pajtuan, në bazë të nenit 345 të KPPK që të lexohen dëshmitë e dhëna nga këta dëshmitarë në gjykimin e mëparshëm. Trupi gjykues ka vendosur në pajtim me këtë.

Lista e provave materiale gjendet në dosjen e lëndës, e cila është shpallur përpara ekzaminimit të pandehurit dhe ishte si në vijim:

Nga dosja e lëndës:

1. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P.no 862/06 i datës 09 maj 2008 kundër L. Xh. dhe M. N..
2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ap-Kz no 435/2008 i datës 22 qershor kundër L. Xh. dhe M N.
3. Të gjitha procesverbalet e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kundër L. Xh. dhe M. N..
4. Deklaratat e të bashkë-pandehurit R.S. (të datës 04 maj 2005 dhe një e dhënë në shqyrtimin kryesor më 28 qershor 2010)
- 5 Deklaratat e L. Xh. (të datës 13 dhjetor 2005 dhe një e dhënë gjatë shqyrtimit kryesor më 27 prill 2010)
6. Deklaratat e M. N. (të datës 19 janar 2006, 30 janar 2006 dhe një e dhënë gjatë shqyrtimit kryesor më 29 prill 2010.)
7. Deklarata e L. J. e datës 22 korrik 2005, për të cilën palët u pajtuan që të merret në konsideratë sikur që u lexua në procesverbal gjatë dëgjimit të datës 07 maj 2010;
8. Komunikata e Interpol Oslo e datës 11 maj 2005
9. Dokumentacioni nga lënda civile e Norway Invest Kosova dhe Kosova Invest v. PTK dhe lënda KTA no PP-KT 324 /06
10. Raportet e Njësisë Hetuese Financiare të UNMIK-ut të datës 25.04.2005 dhe 29 06.2005 dhe anekset e tyre.
11. Rendi i ditës së mbledhjes lidhur me TETRA, i datës 12 shtator 2002,
12. Letra nga Norway Invest Kosova për KTA , e datës 2 dhjetor 2003
13. “Procesverbali nga mbledhja në vazhdim”, 3 dhjetor 2002
14. “Procesverbali i mbledhjes në vazhdim lidhur me rrjetën Tetra” i datës 04 dhjetor 2002
15. Procesverbali i mbledhjes së 12 dhjetorit 2002.

16. Epstar Aneks 3, Mbledhjet lidhur me fazën 1
17. Procesverbali i mbledhjes së Projektit Tetra të datës 06 janar 2003.
18. Procesverbali i mbledhjes në mes të KTA dhe Norway Invest të datës 06 shkurt 2003
19. Procesverbali i mbledhjes në mes të KTA dhe Norway Invest, lidhur me Qendrën e të Dhënave të Kosovës të datës 06 shkurt 2003.
20. E-maili nga R. R. për Ove Johansen dhe L. Xh. i datës 27 shkurt 2003.
21. E-maili nga R. R. për Ove Johansen dhe L. Xh. i datës 03 mars 2003.
22. Marrëveshjet e aksionarëve në mes të PTK dhe Norway Invest.
23. Letra nga Norway Invest Kosovo për AKM/KTA Mbledhja 02 dhjetor 2003.
24. Procesverbali i mbledhjes së 04 dhjetorit 2003
25. Letra nga E. M. K. e datës 09 dhjetor 2003
26. Seritë e e-mailave për dhe nga Ove Johansen të dhjetorit 2003.

Propozimet e bëra nga i pandehuri Ove Johansen dhe avokati i tij mbrojtës:

- Dokumentet e Regjistrimit të Norway Invest R&O AS të datës 10 dhjetor 2001 shënuar si prova "A" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010
- Pasqyra Mujore Bankare dhe transferet nga Norway Invest R&O AS dhe Investuesit Norvegjez prej janarit 2002- tetor 2003 shënuar si prova "B" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010
- Dokumentacioni Mujor për të gjitha transferimet nga Norway Invest R&O AS dhe Investuesit Norvegjez prej shkurtit 2002 - tetor 2003 shënuar si prova "C" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010.
- Deklarata e Raiffeisen Bank e datës 17.04.2008, shënuar si prova "D" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010.
- Llogaria e Raiffeisen Bank në emër të M. N. e datës 05.05.2004 shënuar si prova "E" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010.
- Drafti i Marrëveshjes së Aksionarëve, Posta nga Carlotta Mercante bashkangjitur me marrëveshjen e aksionarëve me komente, e shënuar si prova "F" gjatë dëgjimit të 29 prillit 2010
- Raporti i lëshuar nga Kryeinspektori i Policisë lidhur me vendndodhjet

Pas kësaj i pandehuri ishte ekzaminuar gjatë të njëjtit dëgjim të 6.7.2010, pas të cilit vazhduan fjalët përfundimtare.

Më 09 korrik 2010 në praninë e palëve dhe të pandehurit, trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin publikisht. Me një vendim të ndarë ishte ndërprerë paraburgimi kundër të pandehurit me efekt të menjëhershëm lidhur me dënimin me kusht.

## 2. Ligji i aplikueshëm dhe kompetenca e gjykatës

Sipas nenit 2 të KPK, duhet të aplikohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës përpos nëse një ligj më i favorshëm në vazhdim vjen në fuqi.

Duke i krahasuar ligjet të cilat *in abstracto* kishin me qenë të aplikueshme në këtë rast (p.sh. Ligji Penal i Kosovës i dikurshëm dhe Kodi Penal i Kosovës i qershorit 2004) Trupi Gjykses e zgjedh ligjin më të favorshëm (dhe kështu ligji i aplikueshëm në rastin konkret) se është Kodi Penal i Kosovës.

Natyrisht, sipas Ligjit Penal të Kosovës (LPK) të dikurshëm, kryesi i veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, në bazë të nenit 210 paragrafit 4, është dënuar me burgim prej një deri në dhjetë vjet kur dobia materiale tejkalonte 30.000 dinarë.

Në anën tjetër, neni 339 paragrafi 3 (në lidhje me nenin 23 të KPK kur, si në rastin konkret, dobia materiale tejkalon 5000 Euro) kryesi dënohet me një burgim më të favorshëm prej një deri në tetë vjet.

Gjykata kompetente është *ratione materiae* Gjykata e Qarkut, në lidhje me nenin 23, 1, i KPPK, sepse për veprën e ngarkuar parashihet një dënim maksimal prej 8 viteve. *Ratione loci*, Gjykata e Qarkut e Prishtinës, sepse veprat e pretenduara kanë ndodhur në Prishtinë.

### 3. Pretendimet e Prokurorisë

Prokurori Publik ka ngritur aktakuzën kundër Ove Johansen më 4 nëntor 2009 për shkak të veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare në bazë të nenit 339 KPK, në bashkë-kryerje me Leme Xhemën, më mirë të përshkruar më lart.

Poshtë është përmbledhja e pretendimeve të Prokurorit që gjenden në aktakuzë.

- Prej korrikut 2002 deri në mars 2003 Ove Johansen në rolin e tij si *de facto* menaxher i Norway Invest R&O AS, në bashkë-kryerje me L. Xh M. N., R. R. dhe R. S., me qëllim që të përfitojë dobi materiale të paligjshme, ka kontribuar qenësisht në sjelljen penale të L. Xh. e cila ka shpërdorur pozitën e saj zyrtare si Drejtoresh e Përgjithshme e PTK duke lëshuar një urdhër pagesë të paligjshme prej 300.000 Euro për Norway Invest R&O AS. Transferimi ka shkaktuar humbjen prej 300.000 Euro për PTK dhe ka rezultuar me përfitim material të paligjshëm të Ove Johansen prej 250.000 Euro. Me qëllim që të kryhet pagesa, ai ka qenë i përfshirë në përgatitjet për krijimin e një kompanie të quajtur ARTET – një ndërmarrje e përbashkët në mes të PTK dhe një kompanie norvegjeze të quajtur Norway Invest R&O AS: qëllimi i ARTET duhej të ishte të krijojë dhe zbatojë një rrjetë digjitale të quajtur TETRA në territorin e Kosovës, e cila do të justifikonte pagesën prej 300.000 EUR për Norway Invest. ARTET, pra, kurrë nuk ka arritur të ekzistojë.

- Ove Johansen ka marrë pjesë personalisht dhe direkt në zhvillimin e sipërm të veprimit penal dhe si menaxher i Norway Invest R&O AS dhe të kompanive tjera të lidhura me Norway Invest.
- Veçanërisht, Ove Johansen ka qenë në mesin e atyre që kanë krijuar dhe menaxhuar kompaninë. Lidhur me emrin e kompanisë “ Norway Invest R&O AS” sugjerohet se kompania ishte kreacion i R. S. dhe Ove Johansen (R&O). Ove Johansen “ka qenë njëri që ka pasur idenë për krijimin e kompanisë” edhe pse ai nuk ka pasur rolin formal në te.
- Ove Johansen ka qenë i pranishëm kur memorandum i mirëkuptimit ishte nënshkruar në mes të Norway Invest R&O AS dhe PTK.
- Përpos kësaj Ove Johansen ka përfaqësuar kompaninë në marrëdhëniet e saja të jashtme me palët tjera. Për më tepër Ove Johansen ka pasur autorizim që të ndërmer veprimet obliguese ligjore për kompaninë. Për shembull, Ove Johansen ka pranuar M. N. që të punojë për Norway Invest Kosovo dhe ka qenë Ove Johansen ai që ka nënshkruar në emër të Norway Invest procesverbalin e mbledhjes së 6 shkurtit 2003 me AKM/KTA. Për më tepër Ove Johansen ka pasur autorizim që të udhëzojë vartësit e tij.
- Në anën tjetër Ove Johansen ka luajtur rolin qenësor në shpërdorimin e pozitës zyrtare të kryer nga L. Xh. Natyrisht shuma e transferuar prej 300.000 EUR, larg asaj të ishte iniciativa e vet L. Xh., ka qenë një operacion mashtrues i planifikuar me kujdes dhe me të cilin janë pajtuar L. Xh. dhe Norway Invest R&O AS.
- Norway Invest R&O AS ka qenë një kompani e rrejshme e themeluar nga Ove Johansen dhe të tjerët për të kryer transaksionin mashtrues me PTK. Ishte regjistruar në Regjistrin e ndërmarrjeve të Biznesit në Norvegji më 26 01.2002, vetëm një muaj përpara se kanë filluar kontaktet dhe negociatat me PTK. Norway Invest nuk ka pasur ekspertizën në telekomunikacione. Objektiva e biznesit ka qenë “*marra me sigurimet, blerja dhe zhvillimi i patundshmërisë, shitja dhe qiradbënia e pronës*” dhe ka kërkuar prej një kompanie tjetër (Epstar) që të përgatis edhe draftin paraprak të një plani kryesor për projektin Tetra.
- Norway Invest R&O AS nuk ka pasur kontakte ose nuk merrej me pronarët legjitim të platformës Tetra, nuk ka pasur punëtorë, nuk ka pasur asnjë zyre ose lokal në Norvegji, por vetëm një P.O. boks. Norway Invest R&O AS ka paguar tërësisht kapitalin e aksionit prej së paku 100.000 Kruna norvegjeze rreth 12.700 Euro. Ka qenë Norway Invest ( dmth. Ove Johansen) e cila ka dërguar faturën prej 300.000 EUR për PTK (dmth. L. Xh.). Një faturë identike ishte dërguar në PTK nga kompania jo-ekzistuese ARTET; të dy fatura kanë detaje identike duke përfshirë

- përshkrimin e numrit të faturës, adresën e kompanisë (në Oslo) dhe numrin e llogarisë bankare (në Prishtinë).
- Pas transferimit të 300.000 EUR prej PTK –Artet llogarisë në Norway Invest, ka vijuar një seri e tërheqjeve dhe transfereve nga ana e M. N. Gjatë 3 marsit ai, i cili ka qenë personi i autorizuar për përdorimin e llogarisë bankare të Norway Invest ka tërhequr 229.000 EUR të holla të gatshme, ka transferuar 15.000 EUR në llogarinë e tij bankare personale dhe ka transferuar 40.000 EUR në një llogari të Norway Invest R&O AS në Norvegji. Në fund 15.000 EUR janë transferuar prej llogarisë së tij personale bankare në një prej llogarive të Ove Johansen . Të hollat që ai ka tërhequr në para të gatshme kanë përfunduar në llogarinë e tij personale bankare, e njëjta gjë ka ndodhur me 89.067 Euro që ai i ka pranuar nga A. S. ( bashkëshortja e R. S.) në Oslo.
  - Më 14 prill dhe 22 prill 2003 Neziri ka bërë dy transferime të 70.000 dhe 180.000 EUR prej llogarisë së tij private bankare në Prishtinë në llogarinë private bankare të Ove Johansen në Beograd. Për më tepër N. ka deklaruar se ai ka vepruar sipas udhëzimeve të Ove Johansen dhe Ronny Sorensen.
  - Të gjitha veprimet e pjesëmarrësve në krim që prej fillimit kanë pasur vetëm qëllimin e transferimit ilegal të hollave për një dobi të paligjshme të Ove Johansen dhe bashkëpunëtorëve të tij.

#### **4. A ka kryet L. Xh. veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare**

L. Xh. u dënua nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës më 9 maj 2008 për shkak të veprës së shpërdorimit të pozitës zyrtare dhe të lidhjes së kontratave të dëmshme, duke i caktuar një dënim unik prej katër viteve.

Pas kësaj Gjykata Supreme ka konsideruar se vepra e shpërdorimit të pozitës zyrtare ka qenë e absorbuar në veprën e lidhjes së kontratave të dëmshme (kështu që elementet përbërëse të shpërdorimit të pozitës zyrtare janë si ekzistuese nga ana e Gjykatës Supreme).

Trupi gjykues pajtohet me konkluzionet e arritura të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës si përgjegjësi e L. Xh. për krimin e shpërdorimit të pozitës zyrtare. Kjo, përkundër një dallimi të rekonstruktionit të pjesshëm të ngjarjeve faktike, sikur që do të theksohet më poshtë, në asnjë mënyrë nuk është pengesë për vërtetimin e përgjegjësisë penale.

Është e nevojshme, për të kuptuar më mirë ngjarjet direkt të lidhura me pagesën e shumës prej 300.000 EUR, të epet (në bazë të elementeve të mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor) një pasqyre e përgjithshme e sfondit.

- Norway Invest R&O AS ka qenë një kompani norvegjeze, me seli në Oslo, në të cilën R. S. ka qenë formalisht Drejtor Ekzekutiv. Ove Johansen nuk ka humbur kohë formalisht me

asnjë post të menaxhimit. Rrethanat e sipërme të gjetura konfirmojnë të gjithat më lart me deklaratat e R. S. (dëgjimi i 27 qershor 2010). Kjo rrethanë u qartësua gjithashtu me deklaratat e L. Xh., M. N. dhe Ove Johansen. Dosja e lëndës përmban certifikatën e regjistrimit të Kompanisë në Regjistrin e Norvegjisë.

- Kompania norvegjeze Norway Invest R&O AS duhet qartë të ndahet nga kompania tjetër (më seli në Kosovë) e quajtur zyrtarisht "Company Norway Invest" (por shpesh e referuar nga dëshmitarët si "Norway Invest" ose "Norway Invest Kosovo"). Kjo ndërmarrje e fundit aktualisht nuk ka qenë një kompani, por një ndërmarrje individuale, e themeluar në dhjetor 2002 nga R. S. dhe ka pasur selinë në Pejton, Prishtinë. Dallimi qartë shihet nga dëshmitari M. N. në deklaratën e tij të 29 prillit 2010. M. N. ka qenë drejtor dhe përfaqësues i autorizuar i Kompanisë së tillë. Përkundër që zyrtarisht ka qenë një ndërmarrje individuale, sipas fjalëve të pandehurit Company Norway Invest ishte menduar të jetë një kompani motër e Norway Invest R&O AS, e cila pretendohet se ka ofruar fonde për çdo veprim të kryer nga kjo. Company Norway Invest ka qenë në praktikë një degë e Kosovës e Norway Invest R&O AS, së paku sipas përshkrimit të pandehurit dhe të dëshmitarit R. S..

- Norway Invest R&O AS së pari u paraqit në Kosovë në vitin 2002 (ose bile në fund të vitit 2001<sup>1</sup>), me qëllim të fillojë një biznes të rrjetës TETRA (dmth. një rrjetë Telecom që lejonte bashkë-komunikacionin në mes të shërbimeve emergjente). Përfaqësuesit e Norway Invest kanë qenë Ove Johansen dhe R. S.. Për këtë qëllim, ata kanë krijuar një strukturë vendore dhe kanë filluar lobimin me aksionarët potencial dhe klientët e një rrjete të tillë të re<sup>2</sup>. Kontaktet e para në mes të Ove Johansen dhe L. Xh., drejtoreshës së përgjithshme të PTK, kanë ndodhur diku në verë të vitit 2002. Sipas dëshmitares Xh, ato kanë qenë të stimuluar nga R. R.

Ove Johansen dhe R. S. kanë luajtur një rol kyç në Norway Invest R&O AS dhe në Company Norway Invest. S. gjithashtu ka pasur cilësinë e zyrtarit këtu, por Johansen normalisht ka përfaqësuar kompaninë (çështja do të sqarohet në vazhdim poshtë).

- Ndërmarrja e Post Telekomit të Kosovës (PTK) ka qenë qartë, në projektin e Norway Invest, partner i parë potencial. Lidhur me këtë, pas një serie të kontakteve fillestare, më 20 nëntor 2002 ishte nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit në mes të PTK dhe Norway Invest R&O AS<sup>3</sup>. Memorandumi i tillë duhet të analizohet me kujdes me qëllim që të vlerësohet vlefshmëria e tij dhe deri ku zgjatet.

- Së pari, në përgjithësi qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit është të qartësojë "mirëkuptimin e ndërsjellë" të palëve kështu që të shmangen keqkuptimet dhe hutitë mbi përmbajtjen dhe kushtet dhe dispozitat gjatë negociatave në vazhdim. Prandaj

<sup>1</sup> Shiko deklaratat e bëra nga i pandehuri Ove Johansen gjatë ekzaminimit të tij më 7 July 2010.

<sup>2</sup> Shiko deklaratat e M.N. dhe R. S., si dhe elaburimin posht në vazhdim.

<sup>3</sup> Memorandum i mirëkuptimit është bashkangjitur Raportit të NjHIF të 24.5.2005 si shtesë 1.

memorandumi i mirëkuptimit nuk është vetvetiu kontratë me të cilën janë krijuar obligimet e ndërsjella. Kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur në rastin konkret, nëse analizohet përmbajtja e memorandumit.

- E dyta, memorandumi qartëson se palët mund të krijojnë (ndonjëherë në të ardhmen) një kompani private të përbashkët “*për të ndërmarr planifikimin e nevojshëm për një Rrjetë TETRA në Kosovë*”.
- E treta, Kompania e tillë e Përbashkët do të ndërmerr, për qëllimin e palëve, detyrat e vlerësimit dhe studimet e fizibilitetit, analizat e biznesit dhe planifikimin, planifikimin e rrjetës, hulumtimin mbi kornizat ligjore, përgatitjen për nevojën për marrjen e licencës për kompaninë e përbashkët, të gjitha planet tjera të prokurimit dhe të implementimit.
- E katërta, PTK dhe Norway Invest do të jenë pronarë të Kompanisë së përbashkët me 50% çdo njëra.

Interesante është se dokumenti, edhe pse e përfshin vetëm PTK dhe Norway Invest, dhe përkundër se ishte nënshkruar nga L. Xh. (në emër të PTK) dhe R. S. (në emër të Norway Invest), është shkruar në letra me logon e AKM/KTA (AKM/KTA nuk ka qenë formalisht pjesë a marrëveshjes).

- PTK u themelua më 14.10.1999 direkt nga një Rregullore e UNMIK-ut, n. 12/1999. Kjo Rregullore ka dhënë Ndërmarrjes së Postës dhe Telekomunikacionit (PTK), si një person legal, autorizimin e nevojshëm që të ofrojë shërbimet postare dhe të telekomunikacioneve (neni 1 i Rregullores). Për këtë qëllim, Rregullorja thotë se PTK është e autorizuar që të përdor asetet postare dhe të telekomunikacioneve në dispozicion në Kosovë, duke përfshirë çfarëdo zmadhimi të vet në të ardhmen.

- Është e rëndësishme që qartë të përshkruhet marrëdhënia e ndërsjellë në mes të PTK dhe të Agjencisë së Kosovës të Mirëbesimit (AKM/KTA), sepse kjo reflektohet në konfiguracionin dhe masën e fuqisë së L. Xh. dhe në nivelet e autorizimeve të nevojshme të saja që të kryej llojet e caktuara të veprimeve.

AKM/KTA u themelua me Rregulloren e UNMIK-ut n. 2002/12 më 13.6.2002 (më vonë e ndryshuar me Rregulloren 2005/18), me qëllim të administrimit të ndërmarrjeve publie dhe shoqërore dhe aseteve që lidhen me to, në mes të cilave seksioni 5.5.b i Rregullores 2002/12 në mënyrë recidive e përfshinë PTK.

Detyrat e AKM/KTA janë përshkruar në seksionin 2 të Rregullores sipas të cilës ajo “*administron Ndërmarrjet si kujdestar i Pronarëve të tyre në pajtim me Rregulloren e tashme dhe Rregulloret tjera, si dhe Udhëzimet Administrative dhe përcaktimeve të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të përgjithshëm mund të lëshojë si më poshtë*”; autorizimet administrative të AKM/KTA më tutje përshkruhen në seksionin 6 të

Rregullores<sup>4</sup>.

Brenda AKM/KTA ka qenë një person zyrtar (në këtë rast ka qenë R.R.<sup>5</sup>) i cili posaçërisht ka qenë përgjegjës për marrjen me çështjet që lidhen me PTK dhe ushtrimin e pushtetit të përshtkruar në seksionin 6 të Rregullores 2002/12. Në disa raste specifike, megjithatë, autorizimet e tilla kanë qenë të rezervuara për instancat më të larta brenda AKM/KTA: referenca i bëhet, veçanërisht autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të PTK për pagesat prej më tepër se 25 mijë EUR.

- më 12.12.2002 Company Norway Invest ka hapur llogarinë e vet bankare (150100100171842);

- më 15.1.2003 Norway Invest R&O AS ka dërguar një faturë (me numër 301001) në PTK për një shumë prej 300.000 Euro, me justifikim vijues: “*ARTET Zhvillimi i biznesit ka caktuar shumën totale prej 1 qershorit 2002 gjerë më 10 mars 2003 prej 600.000 Euro*”. Gjërat e treguara në faturë si bazë për faturë janë si në vijim: “*Zhvillimi i biznesit dhe tregut*”, “*Analiza e marketingut dhe zhvillimi i marrëdhënieve me klientët gjerë më dhjetor 2002*” dhe “*Shpenzimet e papritura 6.25%*”<sup>6</sup>.

4 “Agjencia do të ketë autorizim administrativ lidhur me të gjitha ndërmarrjet. Autoriteti i tillë do të përfshinë cilindo veprim, përpos të atyre të përcaktuara në seksionin 6.2, të cilat Agjencia i konsideron të jenë me vend për të ruajtur ose rritur vlerën, realizueshmërinë, ose qeverisjen e Ndërmarrjes së caktuar duke përfshirë:

- (a) Caktimi dhe zëvendësimi i kryetarit, drejtorëve dhe menaxherëve të një Ndërmarrjeje;
- (b) Krijimi, konfirmimi ose ndërrimi i përbërjes së bordit mbikëqyrës të një Ndërmarrjeje;
- (c) Modifikimi i autorizimit të cilit do prej trupave të lartpërmendur;
- (d) Lëshimi i udhëzimeve lidhur me operacionet e një Ndërmarrjeje, veçanërisht politikat për menaxhim të shëndosh;
- (e) Marrja e kontrollit direkt mbi një Ndërmarrje, duke përfshirë llogaritë dhe asetet e saja, dhe administrimin e llogarive dhe asetëve të tilla, ndaras nga llogaritë e Agjencisë;
- (f) Bërja e auditimeve të jashtme të Ndërmarrjes në mënyrë direkte ose nëpërmes të agjentëve të caktuar;
- (g) Të kërkojë nga cilido i punësuar ose kontraktor ose kontakti tjetër i biznesit të një Ndërmarrjeje të jep informacione në posedimin e tij lidhur me Ndërmarrje të tillë;
- (h) Të kërkojë nga cilido person që ka kontrollin mbi dokumente lidhur me Ndërmarrje që të jep qasjen ndaj dokumenteve të tilla për shikimin e tyre, kopjimin dhe ruajtjen;
- (i) Të hysh dhe inspektojë objektin e Ndërmarrjes;
- (j) Të aprovojë planet e biznesit dhe planet e investimeve të Ndërmarrjes;
- (k) Të lëshojë ose modifikojë kartat, rregulloret dhe dokumentet tjera relevante të ndërmarrjes;
- (l) Të bëjë regjistrimin e Ndërmarrjes në Kosovë që nuk është e regjistruar në mënyrë të rregullt;
- (m) Të hyn në aranzhime për menaxhim, rekonstrukcion ose riorganizim të Ndërmarrjes;
- (n) Dhënia e koncesioneve ose qirasë lidhur me Ndërmarrjen;
- (o) Themelimi i një ose më tepër korporacione të Ndërmarrjes, pronë e këtyre Ndërmarrjebe por të administruara nga Agjencia, dhe transferimi i pjesës ose të gjitha asetëve të Ndërmarrjes së tillë te korporacionet e tilla;
- (p) Transformimi i Ndërmarrjeve në Korporacione;
- (q) Restructuring an Enterprise into several Enterprises and/or Corporations;
- (r) Kontraktimi i pjesës së aktiviteteve të Ndërmarrjes; dhe
- (s) Inicimi procedurës së falimentimit lidhur me Ndërmarrjet dhe/ose përfaqësimi i Ndërmarrjes së tillë në procedurën e falimentimit”.

<sup>5</sup>Të gjithë dëshmitarët janë të qartë lidhur me çështjen dhe i njëjti i pandehur nuk e konteston këtë.

<sup>6</sup>The invoice can be found in the case file as attachment 9 to the FIU Report of 24.5.2005.

- më 6 shkurt 2003 (sipas dy fletëve të shënuara si “Formimi i ARTET Kompanisë së përbashkët – procesverbal i mbledhjes së 6 shkurtit 2003”) përfaqësuesit e AKM/KTA dhe të Norway Invest (por, vetëm, pa pjesëmarrjen e asnjë përfaqësuesi të PTK, e cila ishte dashur të ishte pjesë e Kompanisë së Përbashkët) kanë marrë pjesë në një mbledhje në të cilën me gjasë ka pasur diskutim lidhur me mundësinë e krijimit në të ardhmen të një Kompanie të Përbashkët. Gjithashtu ishte deklaruar se “Z. R. R-it i ishte dhënë autorizimi që të aprovojë një buxhet për PTK që do të mbulonte 50% të shpenzimeve për fillimin dhe zhvillimin një biznesi që aktualisht ishte kryer nga Norway Invest që ishte përfaqësuesi Euro 400.000”. Dëshmitarët L. Xh. dhe M. D.T. kanë bërë të qartë se ARTET (TETRA lexohet mbrapshtë) është një Kompani e Përbashkët të cilës i referohet memorandum i mirëkuptimit.

- në mes të 28 shkurtit dhe 1 marsit 2003 PTK ka transferuar një shumë prej 300.000 Eurove Kompanisë Norway Invest si pagesë me një faturë të lëshuar nga Norway Invest R&O AS.

- më 4 mars 2003 ishte lëshuar një faturë tjetër, me përmbajtje identike si ajo e mëparshme, por këtë herë ishte dërguar në PTK jo nga Norway Invest, por nga ARTET.

- më 14 dhe 22 prill M. N. ka transferuar në llogaritë bankare në Serbi të Norway Invest Belgrade/Ove Johansen shumën e përgjithshme prej 250.000 EUR.

Në bazë të kësaj tani është e mundur të vlerësohet më qartë ekzistimi i elementeve përbërëse të krimin të pretenduar.

#### **4.1. Lidhur me pozitën e mbuluar nga L. Xh.**

Është konstatuar (dhe nuk është kontestuar nga asnjë palë) se L. Xh. kishte një pozitë zyrtare brenda PTK. Ajo u ekzaminua si dëshmitare gjetë dëgjimit më 27.4.2010<sup>7</sup>, kur ajo e konfirmoi pozitën e saj si drejtoreshë e përgjithshme aty. E njëjta gjë ishte deklaruar nga dëshmitarët N. dhe T.

Sikur që u sqarua më lartë, PTK në kohën e ngjarjeve ka qenë një ndërmarrje shoqërore publike. Struktura e brendshme e kompanisë, lidhja e saj direkte vartëse ndaj Agjensionit të Kosovës për Mirëbesim, disiplina e saj dhe organizimi legal e bëjnë të qartë se fuqia dhe autorizimet të cilat i kishte L. Xh. kanë qenë të natyrës publike.

Kjo përfshinë atë që si drejtoreshë e përgjithshme e PTK, ajo ka pasur cilësinë e personit zyrtar dhe kështu ka qenë në gjendje që të kryej krimin e shpërdorimit të pozitës zyrtare.

Gjykata e Qarkut e Prishtinës tashmë e ka dënuar L. Xh. mbi këto baza dhe Gjykata Supreme ka vërtetuar dënimin lidhur me këtë pikë.

---

<sup>7</sup> Faqja 5 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor: “Unë kam qenë Drejtoreshë e Përgjithshme e PTK, brenda përgjegjësi të AKM/ KTA. Pozita ime ishte të menaxhojë kompaninë të ofro shërbimet klientëve të Kosovës, të ngriti profitet për kompaninë të prezantojë prodhimet e reja dhe shërbimet në Kosovë, dhe të ngriti strukturën e kompanisë në nivelin më të lartë dhe të bashkëngjitet standardeve Evropiane”.

## 4.2. Mbi pagesën e 300.000 EUR të urdhëruar nga L. Xh.

Është vërtetuar se L. Xh. ka urdhëruar pagesën e 300.000 EUR në llogarinë bankare të Company Norway Invest dhe duke e bërë këtë ajo ka keqpërdorur autorizimet e saja. Natyrisht:

**4.2.1.** më 28 shkurt 2003 L. Xh. ka urdhëruar transferimin e një shume prej 300.000 EUR nga llogaria bankare e PTK (c/o Raiffeisen Bank, n. 1501000000007346<sup>8</sup>) në nën-llogari të quajtur "PTK-ARTET" (c/o Raiffeisen Bank n. 1501000000098837). Gjithashtu është vërtetuar se në vazhdim më 1 mars 2003 hollat ishin transferuar nga nën-llogaria e tillë në llogarinë bankare të Company Norway Invest c/o Raiffeisen Bank n. 150100100171842, e hapur më 12.12.2002. Këto fakte janë konfirmuar nga dëshmitarët D. T., L. Xh. dhe M.N. me deklaratat e tyre dhe nga ana e të pandehurit (faqja 10 e procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 7 korrik 2010). Aty janë, për më tepër, provat complete dokumentuese mbi pagesë, që përbëhet nga fatura e dërguar në PTK (mbi të cilën shiko poshtë) dhe në dokumentacionin bankar të fituar gjatë hetuesisë nëpërmes të urdhrit për zbulim<sup>9</sup>.

**4.2.2.** Pagesa e tillë ka mundur të urdhërohet nga L. Xh. vetëm në cilësinë e saj të drejtoreshës së përgjithshme të PTK. Kjo rrethanë është konfirmuar tërësisht nga ajo<sup>10</sup>. Ekzistojnë provat shtesë dokumentuese që përbëhen nga urdhri për pagesë i nënshkruar nga L. Xh.. Pastaj prova gojore e kësaj vjen nga deklaratat e M. N., R. S.<sup>11</sup> dhe M. D. T.<sup>12</sup>

L.Xh., edhe pse ka pranuar se ka urdhëruar pagesën, ka pohuar se ajo ka bërë këtë në mënyrë të ligjshme, duke qenë e urdhëruar nga Z. R. R. i cili brenda AKM/KTA ka qenë zyrtar përgjegjës për PTK. Kjo mbrojtje nuk është e vlefshme, sikur që do të theksohet më poshtë.

**4.2.3.** Është vërtetuar se nuk ekzistonte kontrata ose justifikimi ligjor që të urdhërohet pagesa, dhe se përpos kësaj L. Xh. nuk ka pasur lejen e nevojshme nga AKM/KTA. Përkundër kësaj, i pandehuri ka vazhduar me pohim se për palët ka qenë e qartë se aty jo vetëm se ka qenë një marrëveshje sipas të cilës shpenzimet për fillimin e kompanisë do të ndaheshin në pjesë të njëjta, por gjithashtu se një linjë e buxhetit ka qenë e aprovuar nga AKM/KTA për pagesën e një kontributi fillestar prej 300.000 Eurove nga PTK për Norway Invest.

Gjërat vijuese vërtetojnë se i pandehuri ka pasur gabim:

---

<sup>8</sup> Pasqyrat bankare e llogarisë së PTK janë bashkangjitur dosjes së lëndës, Raporti i NjHF 25.4.2005, aneksi 13.

<sup>9</sup> Pasqyrat bankare gjenden në dosjen e lëndës, si aneksi n. 13 i Raportit të NjHF i 24.5.2005. Vet i pandehuri gjatë shqyrtimit kryesor ka dhënë Trupit Gjykses një kopje shtesë të po të njëjta dokumenteve.

<sup>10</sup> Shiko procesverbalin e shqyrtimit kryesor të 27.4.2010, faqja 11.

<sup>11</sup> Shiko deklaratat e 27.4.2010 faqja 12-13.

<sup>12</sup> Shiko procesverbalin e gjykimit të 29 qershorit 2010, faqet 3; 6 ff.

- a. Memorandumi i mirëkuptimit i nëntorit 2002 nuk ka krijuar një obligim të detyrueshëm të PTK që të paguaj 50% të shpenzimeve të përcaktuara nga Norway Invest R&O AS. Memorandumi nuk bënë fare referencë lidhur me shpenzimet e përcaktuara, duke e kufizuar veten me deklaratë se Kompania e përbashkët e ardhshme do të jetë 50% pronare nga secila palë. Përpos kësaj, veçanërisht është relevante të vërehet se memorandumi qartëson se qëllimi i palëve do të jetë Kompania e Përbashkët (nëse dhe kur themelohet), do të zhvillojë *“studimet e vlerësimit dhe fizibilitetit, analizën e biznesit dhe hulumtimet e planifikimit të-rrjetit”*.

Dikush mund të konkludojë nga kjo se krijimi i Kompanisë së Përbashkët ka qenë një parakusht për ekzistimin e së njëjtës, se çfarëdo shpenzimi duhet të ndahet. Trupi Gjykoës vëren, pastaj, se sipas dëshmitarit E. T., i cili në kohën e ngjarjeve ka qenë udhëheqës i Departamentit Ligjor në AKM/KTA, gjithashtu konkluzioni i një memorandumi të mirëkuptimit do kishte pasur nevojë për aprovimin e mëparshëm të AKM/KTA (një aprovim që ka munguar<sup>13</sup>). Deklaratat e E. T. janë të besueshme. Natyrisht, aty ekzistonte një përfshirje direkte profesionale e dëshmitarit që është e llojit teknik, nga pikëvështrimi i cilësisë së tij dhe të rolit në AKM/KTA. Deklaratat e dëshmitarit karakterizohen me një shkallë të lartë të precizitetit dhe përpikërisë dhe nuk është theksuar asnjë element subjektiv ose objektiv i mosbesueshmërisë. Vet mbrojtja, në veçanti, nuk ka ngritur shqetësimet lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit T..

- b. “Joint Company/Kompania e Përbashkët” e përmendur në memorandumin e mirëkuptimit kurrë nuk është themeluar. Është qartësuar nga dëshmitarët dhe nga vet i pandehuri se Kompania e Përbashkët kishte qëllimin e aksionarëve të quhet ARTET. Është vërtetuar se në mes të PTK dhe Norway Invest ka pasur mbledhje, në të cilat kanë marrë pjesë dukshëm përfaqësuesit e AKM/KTA. Është vërtetuar gjithashtu se janë shkëmbyer versionet e draftit të një “marrëveshjeje të aksionarëve” për krijimin legal të ARTET në mes të palëve dhe se AKM/KTA ka qenë e përfshirë në shkëmbimin e e-mailave. Por të gjithë dëshmitarët (R. S., L. Xh., M. D. T, M. N.) kanë sqaruar në fund, për shkak të vendimit të AKM/KTA që mos të procedohet më tutje me projektin, marrëveshja e aksionarëve kurrë nuk ishte finalizuar. Kjo rrethanë është pranuar nga të gjitha palët dhe nga vet i pandehuri.

---

<sup>13</sup> Duk mos qenë i mjaftueshëm të pakën involvimi i Z. Mr R.R, udhëheqësi i seksionit të telekomunikacioneve në AKM/ KTA, por ka qenë i nevojshëm aprovimi i Bordit të AKM /KTA ose, përpara se Bordi u formua, aprovimi i përbashkët i dy drejtorëve menaxhues të AKM/ KTA. Shiko procesverbalin e gjykimit të 29 prillit 2010.

c. Nuk ekzistojnë provat e asnjë marrëveshjeje/ obligimi tjetër që e obligon PTK që të marrë pjesë në shpenzimet që i ka bërë Norway Invest në veprimet e veta të lobimit. Në veçanti, “procesverbali i mbledhjes<sup>14</sup>” së 6 shkurtit nuk mund të interpretohet se epte prova të mjaftueshme për një marrëveshje të tillë. Para së gjithash procesverbali i 6 shkurtit është (sikur që veç është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të lëndës kundër L. Xh. dhe M. N. tepër i dyshimtë, lidhur me dëshminë e L. J.<sup>15</sup> dhe E. T., që në mënyrë radikale dallohet prej tyre. Kjo i sugjeron Trupit Gjykues që ato t’i vlerësojë me kujdes. Ky dokument përshkruan (në një mënyrë kushtëzuese) duke ardhur në ekzistencë perspektiva e Kompanisë së Përbashkët (“rolet që PTK dhe Norway Invest do t’i kishin luajtur”, “ARTET do të ishte si një kompani private”). E dyta, është e qartë se procesverbali nuk tregon se palët aty kanë mbyllur marrëveshjen e aksionarëve. Ato ishin më tepër në fazë të diskutimit (“Norway Invest do të jep një propozim për marrëveshjen e aksionarëve dhe Rregulloren e Kompanisë të asociacionit, rregulloren dhe ligjet, për të u shqyrtuar nga ana e PTK dhe KTA”). Kjo domethënë se në atë kohë nuk ishte arritur një propozim final për formimin e ARTET. Kjo rrethanë është e rëndësishme me qëllim që në mënyrë të duhur të interpretohet fjalia vijuese, që gjendet në procesverbalin në fjalë: “R. R.-it i ishte dhënë autorizimi që të aprovojë një buxhet për PTK për të mbuluar 50% të shpenzimeve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit i cili rast tashti është duke u kryer nga Norway Invest përafërsisht 400.000 Euro”. Fjalia e tillë nuk mund të interpretohet sikur R. aty veç ishte duke e shpallur ekzistimin aktual të buxhetit. Vërtetë:

- a. Sentenca e tillë është shumë gjenerike dhe lakonike. Mund të vërehet, bile nuk është precize lidhur me shumën e saktë e cila kishte me qenë në buxhet (“përafërsisht 400.000 Euro”).
- b. Është në kundërshtim me atë që gjendet në dokumentet tjera të bashkangjitura të dosjes së lëndës: referenca i bëhet procesverbalit të Bordit të Mbledhjes së Drejtorëve të AKM/KTA<sup>16</sup>, ku L. J. (zëvendës i drejtorit menaxhues të AKM/KTA) ka deklaruar qartë se nuk ishte dhënë autorizimi dhe se buxheti nuk ishte aprovuar.

Vet i pandehuri, gjatë ekzaminimit të tij, nuk ka qenë në gjendje të jep prova të mjaftueshme (por vetëm së paku pretendime) të burimit të obligimit të PTK për të paguar. Ai, në mënyrë shumë gjenerike, ka deklaruar se çështja ka qenë e qartë për palët që nga mbledhjet e para, që kanë ndodhur në mes tyre në korrik 2002 dhe se

<sup>14</sup> Aneksi 3 i Raportit NjHF të 24.5.2005.

<sup>15</sup> Deklaratat e bëra nga L.J. gjatë hetimeve janë lexuar në shqyrtimin kryesor. Ato gjenen si anekse të Raportit të NjHF të 24.5.2005.

<sup>16</sup> Aneksi 7 i Raportit NjHF i 24.5.2005

aty nuk do të kishte kurrfarë problemi sikur projekti të kishte “nisur” dhe të mos ishte suspenduar nga AKM/KTA<sup>17</sup>. Sidoqoftë, ai vet ka pranuar qartë, duke u përgjigjur pyetjes precize të Kryetarit të Trupit Gjykses, se obligimi i PTK për të paguar do të kishte nevojë për krijimin e mëparshëm të kompanisë së përbashkët (“**Ove Johansen:** Nuk është e çuditshme, normalisht palët diskutojnë se a do të jetë një marrëveshje e cila do të kishte përmbajtjen e një marrëveshjeje, në kuptim të ndarjes së shpenzimeve. **Kryetari i Trupit Gjykses:** Është një gjë të diskutohet diçka dhe një gjë tjetër të ulet dhe të formalizohet një marrëveshje. Ju vet jeni duke thënë se “sikur” të ishte mbyllur një marrëveshje, atëherë palët gjithashtu do të ishin pajtuar mbi atë se si të ndajnë shpenzimet. Por aty është një “sikur” i madh, një kusht i madh që i paraprinë kësaj, i cili duhet të përmbushej. **Ove Johansen:** Ishte e qartë për palët se sikur të ishte përmblyllur një marrëveshje se aty do të ishte një dispozitë”)

- d. Edhe pranimi se një buxhet ka qenë i aprovuar, dhe se AKM/KTA ka autorizuar PTK që të kontribuojë në shpenzimet që veç i ka bërë kinse Norway Invest, nuk ka prova mbi ekzistimin dhe të shumës së shpenzimeve të bëra nga Norway Invest lidhur me Projektin TETRA. Strategjia e mbrojtjes së Ove Johansen deri në këtë masë është e qartë: ai pohonte gjatë ekzaminimit të tij dhe gjatë gjithë gjykimit se

<sup>17</sup> Për të kuptuar më mirë vlen të përkujtohen këtu deklaratat e bëra nga Ove Johansen kur ai përgjigjej ekzaminimit përpara trupit gjykses më 6 korrik 2010:

**Kryetari i Trupit Gjykses:** A kanë qenë këto shpenzime deri në qershor 2002 në mes të shpenzimeve që duhet të përfshiheshin nëndarjen 50% me PTK?

**Ove Johansen:** Jo thotë prej 1 qershorit 2002 që është dita kur PTK ka kontaktuar Norway Invest. Ju mund ta shihni këtë nga faturat.

**Kryetari i Trupit Gjykses:** Ku sipas mendimit të juaj thotë se shpenzimet duhet të ndahen 50/50

**Ove Johansen:** Veç prej korrikut 2002 ka ekzistuar kjo marrëveshje

**Kryetari i Trupit Gjykses:** ku është prova e kësaj?

**Ove Johansen:** Në procesverbal.

**Kryetari i Trupit Gjykses:**Nëse ju mund të na përkujtoni mbi këto procesverbale, nëse mund të na tregoni vendin ju lutem.

**Ove Johansen:** Unë do të mundohem dhe do ta gjej. Ju e keni në librin e trashë.

**Kryetari i Trupit Gjykses:** Procesverbali i çkafit?

**Ove Johansen:** Procesverbali në mes të PTK/KTA dhe Norway Invest, i fundit që ishte zhvilluar në janar. Aty është bashkangjitur në dosjen e lëndës si 1 2 dhe 3 për KB. Është një raport i datës së prillit 2008 i dorëzuar në rastin e L. Xh-ës. Është raporti për KB në New York.

**Kryetari i Trupit Gjykses:** Z. Johansen, ju e dini se në korrik 2002 ka qenë në një marrëveshje në mes të PTK dhe NI-as bile në MM i cili është vetvetiu vetëm një formë e marrëveshjes jo obliguese), prandaj më duket e pabesueshme se bile përpara MM veç ka qenë një marrëveshje mbi ndarjen e shpenzimeve 50/50!

**Ove Johansen:** Është e çuditshme, normalisht palët diskutojnë se nëse do të ketë ndonjë marrëveshje se kjo do të ishte përmbajtja e marrëveshjes, në kuptim të ndarjes së shpenzimeve.

**Kryetari i Trupit Gjykses:** Është një gjë të diskutohet diçka dhe një gjë tjetër të ulet dhe të formalizohet marrëveshja. Ju vet jeni duke thënë se “sikur” të kishte qenë një marrëveshje e mbyllur, atëherë palët do të pajtoheshin edhe mbi atë se si të ndajnë shpenzimet: Por ekziston një “sikur” i madh, një kushti i madh para kësaj, i cili duhet të plotësohet.

**Ove Johansen:** Për palët ka qenë e qartë se sikur një marrëveshje të ishte përmblyllur atëherë do kishte qenë dispozita”.

Norway Invest ka investuar mbi një milion EUR në Kosovë. Veçanërisht, Ove Johansen ka pohuar gjatë ekzaminimit të tij se:

- a. Që nga nëntori/dhjetori 2001 pesë deri dhjetë konsulentë ndërkombëtar kanë qenë duke punuar në projekt, që duhej të paguheshin 15.000 EUR në muaj<sup>18</sup>;
- b. Se çmimi i stafit vendor dhe qiraja për zyre ishte rreth 45.000 Euros në muaj<sup>19</sup>;
- c. Se disa prezantime dhe veprime të trajnimit kanë qenë të organizuara çdo javë nga Norway Invest në Kosovë;
- d. Se në fund (në mars ose prill 2003) shpenzimet “janë rritur mbi 100.000 Euro” në muaj, në lidhje me udhëtimin zyrtar për Finlandë të organizuar për një grup të zyrtarëve nga Kosova.

Shpenzimet e përgjithshme të cilat janë pretenduar në faturë kanë qenë 600.000 EUR, gjysmën e të cilave ka kërkuar Norway Invest që t’i kthehen. Gjatë ekzaminimit të tij, si dhe në një rast tjetër gjatë shqyrtimit kryesor, Ove Johansen ka pohuar se shpenzimi i përgjithshëm bërë nga Norway Invest ka qenë edhe shumë më i madh (deri në 1.1. Milion Euro, të cilave duhet të ju shtohen 6-700.000 Euro tjera, të shpenzuara nga Norway Invest lidhur me projektin e Qendrës së të Dhënave të Kosovës, që është një Projekt tjetër IT që ata mundoheshin ta zhvillonin në një ndërmarrje me interes të përbashkët me PTK).

Gjatë ekzaminimit të bashkë-pandehurit R. S., Ove Johansen pohonte se shumica e përgjithshme e shpenzimeve të bëra nga Norway Invest ka qenë, deri me datën 1. mars 2003, rreth 790.000 Eur.

Ky rreth i dallimit të shumave të dhënë nga i pandehuri (dhe, me rastin e akt-lutjes së 28 qershorit 2010, nga bashkë-pandehuri i tij R. S.) është demonstrim i pasaktësisë së alibitë të cilin i pandehuri mundohet të aktivizojë (dhe vetëm është rasti të theksohet se deklaratat e R. S. duhet të konsiderohen me kujdes më të madh, duke e konsideruar faktin se ai, duke qenë i bashkë-pandehur, ka tërë interesin që të gënjejë në favor të Ove Johansen).

Në kundërshtim me atë që ka deklaruar Ove Johansen mund të vërehet se:

- a. Pohimi i pretendimit se disa konsulentë ndërkombëtarë kanë qenë direkt të paguar nga Norway Invest R&O AS nuk shton asgjë në favor të pandehurit, pasi që ai ka qenë i paqartë lidhur me shumën e përgjithshme të konsulentëve

<sup>18</sup> Shiko ekzaminimin e Ove Johansen, procesverbali I shqyrtimit kryesor i 6 korrikut 2010, faqja 10

<sup>19</sup> Shiko përsëri procesverbalin e gjykimit të 6 korrikut 2010, faqja 10: I pandehuri pohon se 19.000 EUR në muaj kanë qenë për paga, 9.500 kanë qenë shpenzimet e qirasë, 2.000 për taksa për Komunën e Prishtinës, 2.000 deri 5.000 EUR për gjeneratorë dhe karburant, 7.000 ose 8.000 për shpenzime operacionale

ndërkombëtarë të pohuar se janë angazhuar nga Norway Invest dhe lidhur me kohëzgjatjen e në të cilën çdo njëri ka punuar për kompaninë. I pandehuri nuk ka qenë i qartë mbi atë nëse konsulentët kanë punuar vetëm në projektin TETRA ose (sikur që duket të jetë rasti) edhe në projekte tjera të ndryshme. Asnjëri prej dëshmitarëve në mesin e atyre të përmendur nga i pandehuri gjatë dëgjimit të 6.7.2010 (me rastin e rihapjes së shqyrtimit kryesor pas ndërrimit të një anëtari të trupit gjykues) nuk ka dhënë konfirmimin e përmasës dhe sasisë së shumave të shpenzuara për to;

- b. Lidhur me shumën e pretenduar prej 45.000 EUR për shpenzimet e bëra, duhet të theksohet se sipas asaj që ka deklaruar M. N., gjatë disa muajve duke filluar nga korriku 2002 numri i të punësuarve ka qenë vetëm dy (dmth. vet M.N. dhe M. D.) dhe se që nga atëherë gradualisht disa të punësuar tjerë janë rekrutuar, gjerë në numrin 12-13. Dikush nuk mund të sheh, prandaj, si është e mundur të besohet pretendimeve të Ove Johansen mbi shumën e shpenzimeve mesatare mujore të Company Norway Invest.
- c. Lidhur me shumën kinse të shpenzuara për prezantime, i pandehuri është edhe më i paqartë lidhur me shumën e përfshirë. Sidoqoftë mund të argumentohet se prezantimet e tilla bien brenda fushës së veprimeve normale të punësuarve të Norway Invest, dhe kështu është vështirë që ato të futen si një linjë shtesë e buxhetit.
- d. “Fakti i gjetjes së udhëtimit për Finlandë” të organizuar nga Norway Invest aktualisht ka ndodhur pasi që ka ndodhur pagesa, prej 5 deri 9 mars 2003<sup>20</sup>.

Në kundërshtim me deklaratat e Ove Johansen, për më tepër, është veçanërisht e rëndësishme të vërehet se nuk kishte çfarëdo dokumente mbështetëse që janë venë në dispozicion të gjykatës lidhur shpenzimet kinse të bëra nga Norway Invest. I pandehuri pretendon se hetuesve të NJHF u janë dhënë 250 faqe të dokumentacionit mbështetës. Edhe njëherë, prapë se prapë, i pandehuri është plotësisht i paqartë mbi identitetin e dokumenteve të tilla të pretenduara. Dhe se asnjë dokument mbështetës nuk ka qenë i dërguar nga Norway Invest në PTK, gjë që është konfirmuar edhe me e-mailin që ishte dërguar nga R. R. te Ove Johansen dhe nga marrësit tjerë më 27 shkurt 2003 (dmth. vetëm një ditë përpara se ishte urdhëruar pagesa nga PTK për Norway Invest). Në këtë e-mail R. shkruan se “*fatura e dërguar B. Rs*” (dmth fatura e Norway Invest) “*nuk mund të përdoret për transferimin e fondeve prej PTK në një llogari të Norway Invest përpos nëse faturat e detajuara mbështetëse nuk janë dhënë nga furnizuesi original ose shpenzimet interne aktuale të Norway Invest nuk janë specifikuar*”. Kjo vetëm donë me thënë se fatura nuk ka qenë e dhënë me dokumente mbështetëse. Ky është rasti të

---

<sup>20</sup> Shiko faqen 20 të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës te rasti kundër L. Xh. dhe M.N.

shtohet se gjithashtu L. Xh. nuk ka mundur të konfirmojë se ka parë faturat e tilla. Përpos kësaj, hetuesi i UNMIK-ut i cili ka qenë përgjegjës për hetuesinë, M. D. T., ka konfirmuar se dokumentet mbështetëse të cilat Ove Johansen pretendonte se ishin mbështetje për pagesën e 300.000 nuk kanë mundur të gjenden gjatë hetimeve (faqja 8 e procesverbalit të shqyrtimit kryesor të 29 qershorit 2010). As bile konsultimi i pasqyrave bankare të Norway Invest nuk japin mbrojtjen e Ove Johansen me një substancë më solide lidhur me zgjatjen dhe shumën e shpenzimeve të bëra nga Norway Invest për Projektin TETRA.

Vërtetë, edhe duke supozuar se të gjitha shumat që janë transferuar prej Norvegjisë në llogaritë e Norway Invest kanë qenë të përdorura për Projektin TETRA (dhe kështu, sipas teorisë së të pandehurit, me hipotezë se kanë pasur të drejtë për kompensim në përqindje prej 50%), ende duhet të theksohet si në vijim:

- Shuma e përgjithshme e transferuar është shumë më e vogël se 600.000 EUR.

Veçanërisht:

- o Shumat e transferuara prej Norway Invest R&O AS në llogarinë bankare të Kompanisë Norway Invest (Raiffeisen Bank n. 150100000071842) kanë qenë deri më 10 mars 2003 rreth 147.000 EUR.
- o Shumat e transferuara prej Norway Invest R&O AS në llogarinë bankare personale të M. N. (Raiffeisen Bank n. 1501001000440084) kanë qenë, deri në të njëjtën datë, 123.320 euro.

Prandaj, edhe pranimi (sikur që pohohet nga dëshmitari N.) se të gjitha shumat që ishin transferuar në llogarinë bankare personale të tij kanë qenë të përdorura për aktivitetet e Norway Invest, duhet të konkludohet se nuk ka prova mbi faktin se të hollat e paguara nga Norway Invest kanë arritur shumën prej 600.000 EUR.

- Është plotësisht e paqartë se si këto shuma janë shpenzuar (vërtetë, pasqyrat bankare tregojnë se të hollat janë tërhequr në para të gatshme nga llogaritë bankare të Norway Invest: I pandehuri ka dhënë së paku pohimet lidhur me destinacionin dhe totalin e këtyre shumave). Dosja e lëndës përmban provat ekskluzivisht të faturës së dërguar në Norway Invest nga Epstar, një kompani konsulente e cila ka bërë planifikimin për kompaninë e ardhshme ARTET (dhe shuma e paguar Epstar-it ka qenë rreth 16.000 Euro<sup>21</sup>).
- Aktivitetet e lobimit të Norway Invest kanë mbetur plotësisht të papërcaktuara lidhur me sasinë aktuale të tyre. Mund të merret si e vërtetuar se Norway Invest ka pasur mundësinë që të tërheqë interesimin e zyrtarëve të shkallës së lartë. Kjo nuk e nënkupton, pra, që PTK duhej të paguante për këtë aktivitet, i cili duhet

---

<sup>21</sup> Shiko Aktgjykimin e marr nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës, konfirmuar lidhur me këtë nga Gjykata Supreme, faqja 19, pika 3.

më shumë të shikohet se aktivitetet tipik të cilin një partner i biznesit me perspektivë (sikur që është Norway Invest) mundohet të bën me qëllim që të bindë kundër-palën lidhur me profitabilitetin dhe fizibilitetin e investimit që ka qenë i propozuar;

- Duhet të shtohet se vetëm një pjesë e aktiviteteve që pohohet të jenë kryer nga Norway Invest kanë qenë të referuara në projektin TETRA. Vet i pandehuri (dhe dokumentacioni i paraqitur në dosjen e lëndës konfirmojnë pohimin) ka deklaruar se Norway Invest ka investuar një pjesë të madhe të aktiviteteve të veta dhe të fondeve në krijimin e Qendrës së të Dhënave të Kosovës dhe në projekte të ngjashme. Kështu që për shkak të një arsyeje të më tejshme nuk është e mundur të pranohet se të gjitha shumat e pretenduara nga Ove Johansen si të shpenzuara nga Norway Invest (dhe të cilat, sikur që veç është theksuar, kanë qenë më të vogla se sa ato të treguara në faturën e 15.1.2005 si shpenzimet “që ndahen”) të kenë pasur të drejtë për një kompensim nga PTK brenda kornizës së projektit TETRA.

Mund të arrihet deri te një konkluzion i përgjithshëm lidhur me çështjen e shumave (për pjesën kryesore të pohuar) të shpenzuara nga Norway Invest në Kosovë.

Kjo është në lidhje me natyrën e marrëdhënies në mes të PTK dhe Norway Invest, e cila ka qenë (sipas pretendimeve të pandehurit) e partnerëve potencial për një marrëveshje të aksionarëve. Ove Johansen pohon se Norway Invest ka vendosur të investojë në Kosovë dhe mendohej të bindte partnerët potencial mbi profitabilitetin e biznesit, nëpërmes të lobimit (në nivele të ndryshme) dhe me aktivitetet e prezantimit. Prandaj, duhet të përjashtohet se (sikur, në të kundërtën, Ove Johansen duket se pohon në mënyrë naive<sup>22</sup>) PTK duhej të kontribuonte *automatikisht* në të gjitha shpenzimet që kompania norvegjeze kishte detyrë të kryente me qëllim që të krijojë dhe fillojë degën e saj vendore (dmth. shpenzimet e regjistrimit, shpenzimet administrative, qiraja e objektit, rekrutimi i stafit, etj). Përkundrazi, shpenzimet e atij lloji duhej automatikisht të ishin paguar nga Norway Invest, e cila propozonte veten si një partner i besueshëm në një biznes me perspektivë 50%/50% në marrëdhënie

<sup>22</sup> Shiko procesverbalin e 6 korrikut 2010, faqja 17:

**Kryetari i Trupit Gjykoës:** Kur ka filluar Norway Invest të investojë dhe paguaj për këtë projekt  
**Ove Johansen:** Dhjetor 2001. Pra normalisht ata duhej të paguanin nëse donin të ishin një partner dhe përpos kësaj pronarët e PTK kanë dashur të jenë pronarët e rrjetës së dizajnuar nga Norway Invest, duhej ta lenin atë pa paguar? Ata pak a shumë e kanë pasur pa paguar sepse e kanë vjedhur. Tani unë jam duke folur për pronarët, ata kanë paguar një pjesë të asaj që ishte dashur, nëse e shikoni letrën e Eric Mackinley të datës 9.12.2003 ai thotë se projekti u anulua dhe se të gjitha shpenzimet mbi këtë 300 mijë kanë qenë rreziku i vet Norway Invest dhe kështu PTK ka kuptuar në mënyrë të përkryer se çka kanë bërë ata dhe po ashtu AKM/ KTA. Gjithashtu atë që ata kanë paguar, është vetëm policët e NjHF të cilët nuk e kanë kuptuar.

me PTK. Aktiviteti i ndërmarr me iniciativën e Norway Invest ka qenë sipas opinionit të trupit gjykues pjesë e një rreziku ndërmarrës të Norway Invest dhe nuk ka pasur arsye pse të vihen në krahët e PTK pa një bazë të rregullt ligjore. Ky është gjithashtu konkluzioni i arritur nga Dhoma Speciale në faqen 18<sup>23</sup>.

- e. Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme të Kosovës ka refuzuar pohimin e Norway Invest-it kundër PTK dhe AKM/KTA<sup>24</sup>. Në këtë pohim Norway Invest Kosovo dhe Kosovo Invest (të dy kompanitë janë krijuar në pjesën e dytë të vitit 2003 nga Ove Johansen duke e marrë pozitën e Norway Invest R&O AS) kanë kërkuar nga PTK dhe KTA pagesën e 11.756.000 EUR plus interesin për shkeljen e kontratës dhe pastaj për humbjen e të ardhurave në të ardhmen. Si alternativë kërkuesi ka kërkuar pagesën prej 1.877.000 Eurove në bazë të përgjegjësisë së jo kontraktuar. Këto kërkesa kanë pasur përgjigjen e Dhomës Speciale shumë të qartë, dhe plotësisht konfirmohen konkluzionet e arritura të Trupit Gjykues në këtë procedurë penale:
- a. Dhoma Speciale ka përjashtuar qartë memorandumën e mirëkuptimit të nënshkruar më 20 nëntor 2002 në mes të Norway Invest dhe PTK që përmbante dhe vendoste marrëdhënien kontraktuese (faqja 16 e Aktgjykimit); kjo ishte një *“paraprijëse e marrëdhënies kontraktuese”* (faqja 17 e Aktgjykimit);
  - b. Ka aprovuar se memorandumë i mirëkuptimit së paku ka përcaktuar kuptimin e tyre mbi themelimin e ARTET në të ardhmen, por askund në të palët nuk kanë paraqitur përgjegjësitë e themeluesve lidhur me shpenzimet (shiko faqen 18 të Aktgjykimit të Dhomës Speciale);
  - c. Prandaj është përjashtuar që PTK mund të jetë përgjegjëse ndaj Norway Invest, sepse *“ligji kërkon që përgjegjësitë e tilla duhet të parashikohen në marrëveshjet me shkrim të kësaj natyre”* (faqja 18 e Aktgjykimit të Dhomës Speciale);
  - d. Është konstatuar se aktivitetet e kryera nga Norway Invest kanë qenë ekskluzivisht shprehje e një *“vullneti të mirë që të vazhdohet me përgatitjet për implementimin e biznesit të ardhshëm i cili nuk ishte krijuar”* (Aktgjykimi i Dhomës Speciale, faqja 18).
- f. Edhe sikur baza ligjore për pagesën e faturës Norway Invest-it të ishte vërtetuar, L. Xh nuk ka pasur në asnjë mënyrë autorizimin e nevojshëm që të urdhërojë një pagesë

<sup>23</sup> Prandaj është e rrejshme ajo që deklaron i pandehuri (dmth. se Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme ka vendosur se ekzistonte një marrëveshje obliguese në mes të Norway Invest dhe PTK).

<sup>24</sup> Aktgjykimi i Dhomës Speciale (i shpallur më 25 nëntor 2005 në rastin n. SCC-04-0063) gjendet në dosjen e lëndës. Palët aty janë si paditës Norway Invest Kosovo dhe Kosovo Invest (që të dy kompanitë e krijuara nga Ove Johansen, marrin mbi vete pozitën e Norway Invest Kosovo) dhe si të paditurit dhe kundër-paditës janë PTK dhe AKM/ KTA. Është e rëndësishme që të vërehet se PTK-në kundërpadinë e vet ka kërkuar nga Norway Invest kthimin e shumës prej 300.000 Euro të cilat përbënin një *“pasurim të paligjshëm”*.

të tillë. Kjo rrethanë u bë e qartë nga dëshmitari E. T., i cili në dëgjimin e 29 prillit 2010 ka sqaruar se një transfer i të hollave prej 300.000 Euro do të duhej aprovimin e që të dyve, të R. R. dhe të Zëvendësit të Drejtorit Menaxhues të AKM/KTA për Ndërmarrjet Publike Shoqërore<sup>25</sup>. Dhe qartë autorizimi i këtij të fundit ka munguar, sikur që ka deklaruar i njëjti Zëvendës i Drejtorit Menaxhues (në atë kohë L. J.) me rastin e takimit të Bordit të Drejtorëve të AKM/KTA të mbajtur më 20 maj 2003<sup>26</sup>, procesverballi i të cilit thotë si në vijim: “Pastaj Z. J. foli lidhur me çështjen e dytë lidhur me PTK, gjë që ishte projekti i quajtur “ARTET”. Projekti është një investim i përbashkët me Norway Invest, ku PTK kishte të kontribuonte 300.000 Euro për biznesin e ri lidhur me një sistem mobil për provajderiët e sigurimit. Pastaj nuk kishte kontratë, as vendim përfundimtar as të hollat nuk janë paguar nga PTK?”. L. Xh. në gjykimin kundër saj ka pohuar në mënyrë naivët, dhe me të madhe është përkujtuar gjatë dëgjimit në të cilin ajo është dëgjuar si dëshmitare, se ajo ka urdhëruar pagesën sepse asaj i ka urdhëruar R. R. dhe se ajo nuk kishte fare mundësi që të refuzojë një urdhër të tillë. Kjo nuk mund të pranohet, duke marrë në konsideratë autorizimet personale që ajo i kishte. Fakti që R. R. ka qenë personi që, në AKM/KTA, ka ushtruar kontrollin mbi PTK (sikur që u deklarua nga të gjithë dëshmitarët) dhe fakti se ka qenë R. R. i cili “ngrohtësisht ka rekomanduar” L. Xh. për pozitën e Drejtoreshës Menaxhuese të PTK (sikur që deklaroi E. T. gjatë ekzaminimit të tij si dëshmitar më 29 prill 2010) nuk është e mjaftueshme që ajo të lirohet nga përgjegjësia për mos respektimin e detyrës së saj për të vepruar (në menaxhimin e PTK) sipas ligjit, dhe veçanërisht lidhur me çështjen e ndjeshme të pagesës së shumave të mëdha.

**4.2.4.** Pagesa e paligjshme e urdhëruar nga L. Xh. ka shkaktuar një dëm PTK-ës dhe një pasurim joligjor identik të Norway Invest. Konkluzioni është automatik kur merret në

<sup>25</sup> **Kryetari i Trupit Gjyqësor:** Deri më tani për një transaksion financiar prej 300.000 cili ka qenë niveli i kërkuar, kush duhej ta nënshkruante nëse ju kujtohet?

**E. T.:** Do të duhej të ishte shefi i seksionit Roger Reynolds dhe për këtë shumë gjithashtu do të duhej nënshkrimi zëvendësit të drejtorit menaxhues të OSHP në AKM/KTA.

**Kryetari i Trupit Gjyqësor:** Prej kur kjo rregullore e brendshme ka qenë duke u implementuar, a ka qenë veç e përdorur në 2003

**E. T.:** Kjo ishte një prej masave më të hershme të caktuara nga AKM/ KTA sepse PTK është një prej ndërmarrjeve më të vlefshme dhe më fitimpruese në Kosovë, që domethënë se aty kështu një shumë e madhe të likuiditetit përreth, dhe AKM/ KTA ka qenë shumë në dijeni se kjo duhet të kontrollohej, sepse nëse zhduket likuiditeti akuza do të kthehet te AKM/KTA, Njëra prej gjërave të para të ndërmarrja kanë qenë masat e kontrollimit të aktivitetit financiar

**Kryetari i Trupit Gjyqësor:** Pra ju po presupozoni se ka ekzistuar në 2002

**E. T.:** Po jam shumë i sigurt, sepse kjo ka qenë njëra prej masave të para të vendosura nga AKM/ KTA vetëm si një sfond i shtyllës së 4, AKM/ KTA ka marr mbi vete të gjitha OSHP në korrik 2002 dhe sepse atëherë veç ka pasur thashetheme të caktuara lidhur me transaksione financiare të parregullta nga OSHP, kjo ka qenë një prej masave të para kryesore të cilat i ka shikuar AKM/ KTA.

<sup>26</sup> Procesverballi është bashkangjitur “Raportit Penal n. 30/FIU – 15 Jan 2006, si pjesë e aneksit 1

konsideratë se aty nuk ekzistonte obligimi ligjor për PTK për të paguar Norway Invest-it dhe se, sidoqoftë, nuk ekziston evidenca e aktiviteteve të kryera nga Norway Invest në favor të PTK.

**4.2.5.** L. Xh. ka qenë e vetëdijshme mbi paligjshmërinë e pagesës. Ky konkluzion (tashmë është marrë nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme në gjykimin kundër saj) është i domosdoshëm kur konsiderohet cilësia e saj personale e drejtoreshës menaxhuese të PTK. Përkundër tentimeve të saja që të heq tërë përgjegjësinë për atë që ka ndodhur mbi R.R., nuk është e besueshme se ajo nuk ishte në dijeni mbi rregullat specifike që rregullonin pagesat i shumave të mëdha nga ana e PTK. Përpos kësaj ka qenë me siguri e qartë për te (duke qenë e mësuar me ushtrimin e saj të përditshme të pozitës si drejtoreshë) se autorizimi që të urdhërojë pagesën ka qenë ekskluzivisht te ajo dhe se R. R. ka pasur vetëm autorizimin që të kontrollojë dhe (deri në njëfarë mase) autorizojë. Për më tepër, sikur që me korrektësi ka konstatuar Gjykata e Qarkut e Prishtinës në Aktgjykimin e marrë kundër L. Xh.,

- Ajo nuk ka pasur vërejtje për pagesë për shërbime që kanë qenë të faturuara/paguara më 15.1.2003 por lidhur me të ardhmen (fatura që mbulonte periudhën gjerë më 10.3.2003);
- Ajo nuk ka pasur vërejtje që të paguajë një faturë të Norway Invest R&O AS që mbulonte një periudhë duke filluar nga 1.6.2002 në një llogari të Company Norway Invest (një kompani që ka qenë iniciuar vetëm më 10.12.2002);
- PAGESA nuk marrë aprovimin nga AKM/KTA: nënshkrimi i R. R. në urdhrin për transferim nuk mund të interpretohet si një aprovim pagese nga AKM/KTA dhe L. Xh., duke qenë drejtoreshë e përgjithshme përgjegjëse me përgjegjësi financiare, ishte dashur të vërente pozitën tepër të dyshimtë të mbuluar nga R. R. në atë rrethanë (duke qenë edhe menaxheri i divizionit të AKM/KTA/PTK dhe drejtor i kompanisë (jo ekzistuese) ARTET);
- Cilado veprime që ka ndërmarrë Norway Invest R&O AS, vlera e tyre ka qenë e mbivlerësuar tepër, sikur që është treguar më lartë, dhe kjo duhet të kishte qenë e njohur për L. Xh. duke konsideruar kapacitetet e saja si një drejtoreshë e përgjithshme.

Trupi Gjykues përjashton se ka qenë detyrë e L. Xh. që të respektojë urdhrat e pohuara nga R.R..

E para, fakti se ky urdhër ishte dhënë është së paku një pretendim i L. Xh. (e cila gjithashtu në shqyrtimin kryesor kundër Ove Johansen vazhdimisht ka tentuar të tregojë veten si së paku një lodër në duart e R. R.), e cila nuk ka dhënë asnjë provë mbi këtë. Për më tepër, leja e nevojshme nga AKM/KTA ka munguar dhe kështu, sikur që është theksuar nga

dëshmitari E. T., urdhri i pretenduar i R. R. (edhe me pranimin e ekzistimit të tij) do kishte qenë i manifestuar si i paligjshëm.

Në fund, edhe sikur ne të kishim konsideruar nënshkrimin e R. si një autorizim për pagesë, kjo nuk do të kishte arritur të jetë një urdhër (dhe kështu edhe një herë mbrojtja e L.Xh. nuk do të kishte qenë e bazuar).

## 5. A u pajtua Ove Johansen me veprën penale të kryer nga L. Xh.

Ove Johansen është akuzuar se ishte bashkë-kryes me L. Xh. në kryerjen e krimit të shpërdorimit të pozitës zyrtare.

L. Xh. ka pasur cilësinë e një personi zyrtar. Ajo ka pasur autorizimet publike dhe fuqitë, në pozitën e saj të drejtoreshës së përgjithshme të PTK (një kompani publike) dhe prandaj ajo ka qenë ajo që *direkt* ka mundur të abuzojë ato autorizime (të ashtuquajtura “*intra ned*”).

Ove Johansen nuk ka pasur direkt dhe formalisht autorizime zyrtare. Ai ka qenë, folur teknikisht, një “*i jashtëm*”. Dispozitat që gjenden në nenin 23 KPK japin një bazë ligjore për pohimin e përgjegjësisë së tij për krimin e lartpërmendur. Sipas normës së tillë, “*Nëse dy ose më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale*”.

Duke pohuar se “*Thelbësisht duke i kontribuar*” në kryerjen e një krimi e bën bashkë-kryesin përgjegjës sikur ai të kishte kryer vet krimin, domethënë se nëse ekzistojnë provat se Ove Johansen rastësisht ka kontribuar te L. Xh. që të kryej pagesën e paligjshme për Norway Invest R&O AS dhe se kërkesa për *mens rea* është plotësuar, atëherë Ove Johansen mund të dënohet njëjtë si L. Xh., pa marrë parasysh a ka pasur a nuk ka pasur pozitën zyrtare.

Konkluzioni i Trupit Gjykses është se Ove Johansen, duke vepruar në Kosovë si *de facto* përfaqësues i Norway Invest, ka pasur rolin që me vullnet dhe aktivisht të stimulojë, organizimin dhe marrjen e pagesës së paligjshme nga L. Xh..

Prandaj duhet të konkludohet, përtej dyshimit të arsyeshëm, se Ove Johansen u pajtua me kryerjen e veprës nga L. Xh.

Kjo e sipërme mund të konkludohet nga elementet vijuese:

**5.1.** Ove Johansen ka qenë iniciator i biznesit i cili në vazhdim u quajtur Norway Invest R&O AS. Përkundër tentimeve të pandehurit të tregojë veten si së paku një konsulent të kësaj kompanie<sup>27</sup>, Trupi Gjykses ka ardhur deri te konkluzioni i pastër se roli i tij (së paku në kompani me seli në Kosovë, por me gjasë më të madhe edhe në strukturën norvegjeze) ka ishte i shquar, dhe ishte ai se një menaxher përfaqësues-koordinator-i përgjithshëm. Është e sigurt se Ove Johansen ka qenë kreator i strukturës. Ai ka pranuar, gjatë ekzaminimit të tij,

<sup>27</sup> Shiko deklaratat e bëra gjatë ekzaminimit të tij përfundimtar.

se e pasur idenë origjinale (në bazë të përvojave që ai ka pasur në Kosovë<sup>28</sup>) të këtij lloji të investimi. Ai (sipas fjalëve të tija të njëjta) ka qenë i përfshirë në lansimin e iniciativës së Norway Invest jo vetëm në Kosovë, por gjithashtu edhe në Serbi dhe Mal të Zi. Emri i tij paraqitet edhe në emrin e Company-së: domethënë, akronimi “R&O” i cili paraqitet pas Norway Invest, që nuk do të thotë asgjë tjetër por “R. dhe Ove”. I pandehuri gjatë ekzaminimit të tij është munduar me pak sukses të pretendojë se ai nuk ka qenë në dijeni mbi faktin se emri i tij ka qenë i shtuar emrit të kompanisë sipas iniciativës ekskluzive të R. S.. Kjo teori naive është kundër përvojës së zakonshme se pronarët/themeluesit janë ata që vejnë emrat e tyre në emër të kompanisë. Gjithashtu është kundër të gjitha elementeve faktuale (të cilat do të rikujtohen më poshtë) që tregojnë rolin e shquar të Ove Johansen në këtë kompani. Dhe sidoqoftë, edhe nëse ishte e vërtetë se R. S. ka përfshirë emrin e Ove Johansen në emrin e kompanisë pa e njoftuar atë, kjo do të kishte qenë me kuptim gjithsesi lidhur me shquarsinë e Ove Johansen në kompani.

5.2. Ove Johansen ka nënshkruar dokumentet në emër të Norway Invest. Kjo është e vërtetë, për shembull, te nënshkrimi i kontratës së punësimit të M. N., ai ishte drejtori i Company Norway Invest<sup>29</sup>. Dosja e lëndës gjithashtu përmban procesverbalin e nënshkruar nga Ove Johansen në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Norway Invest (rasti i tillë është procesverbalin e 6 shkurtit 2003 (“Formimi i ARTET Joint Company/ARTET Kompania e Përbashkët” dhe “Pasqyra e Qendrës së të Dhënave të Kosovës”: bashkëngjitet 3 dhe 4 të Raportit të NjHF të 24.5.2005). Është interesante të vërehet se këto nënshkrime dhe kjo cilësi vërtetojnë se Johansen gënjen kur deklaroi se prej dhjetorit 2002 e më tutje ai ka dhënë dorëheqje nga pozitat e tija në Norway Invest. Prandaj, fusha e veprimeve në të cilat i pandehuri ka përfaqësuar shoqërinë ka qenë e gjerë, duke mbuluar përfaqësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shoqërisë.

Dokumentet tjera që japin prova mbi aktivitetin menaxhues të Ove Johansen janë e-mailat të cilat janë dërguar atij nga R. R. me rastin e pagesës së faturës prej 300.000 EUR. Përkundër asaj që i pandehuri ka deklaruar (sipas të cilit ai në asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me faturat që janë përdorur për pagesën e paligjshme të 300.000 EUR prej PTK në Norway Invest), e-mailat e përmendura më lartë janë drejtuar prej R. R. (KTA) për Ove Johansen (për Norway

---

<sup>28</sup>Faqja 7 e procesverbalit të 6.7.2010: “Ove Johansen: Unë kam udhëhequr grupin e komisionit që ka filluar Agjencinë e Regjistrimit të Kadastrës së Kosovës KCA. Pra kjo është një që mund të shtohet që nevojitet në Kosovë”

<sup>29</sup> Shiko procesverbalin e 29 prillit 2010, faqja 7:

**Prokurori Publik:** Ju keni pasur një kontratë me Norway Invest R&O AS?

**Mustafa Neziri:** Po, sa më kujtohet.

**Prokurori Publik:** Kush ka nënshkruar kontratën, ju dhe nga ana tjetër?

**Mustafa Neziri:** Mr Johansen.

Invest) dhe për L. Xh. (për PTK). Peter Butcher ishte drejtuar ekskluzivisht në CC<sup>30</sup>. Kjo pastaj thekson autorizimet e tij menaxhuese edhe lidhur me aspekte financiare të Norway Invest, të cilat nuk janë të realizueshme me së paku një menaxher të projektit / konsulent.

5.3. Ove Johansen ishte shikuar si menaxher ose përfaqësues i Norway Invest, së bashku me Ronnie Sorensen. Veçanërisht, kur R. S. ishte i pranishëm, ai ka pasur një rol formalisht më të shquar, dhe kur ai mungonte (gjë që ishte si rregull) roli udhëheqës ka mbetur te Ove Johansen. Kjo është konfirmuar nga dëshmitarët L. Xh.<sup>31</sup> dhe M. N.<sup>32</sup>. Edhe i bashkë-

<sup>30</sup> Ky e-mail veç ishte përmendur më lartë (nën 4.2.b). Në te R.R. ka dhënë udhëzime precize të pandehurit dhe L.Xh. se si të përgatiten faturat që të dërgohen në PTK nga ana e Norway Invest dhe mbi faktin se ishte i nevojshëm dokumentacioni mbështetës, përndryshe nuk ka qenë e mundur të ekzekutohet pagesa.

<sup>31</sup> Shiko procesverbalin e 27.4.2010, faqja 8 dhe në vijim:

*“Prokurori Publik: Gjatë negociatave me Norway Invest, kush ka përfaqësuar Norway Invest?*

*L. Xh: Ronny Sorensen dhe Ove Johansen. Unë kam nënshkruar marrëveshjen me Ronny Sorensen, MM.*

*Presiding Judge: Çfarë role kanë pasur R. S. dhe Ove Johnsen gjatë negociatave me PTK?*

*L Xh: Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me R. S., dhe sa më kujtohet gjatë takimeve që kemi pasur në lidhje me prezantimet, unë ka presupozuar se ai mund të ishte Drejtor i Përgjithshëm ose një investitor ose një aksionar. Unë nuk e di strukturën e tyre. Por më vonë dhe gjithashtu gjatë mbledhjeve të para Ove Johansen ka qenë i pranishëm, i cili ka qenë i përfshirë që nga dita e parë për MM dhe projektin ARTET, dhe i cili ka marrë pjesë rregullisht në mbledhjet në PTK. Në bazë të shënimeve që unë kam parë, edhe Mustafa Neziri, përpos të përfaqësuesit të saj nuk e di saktësisht. Për stafin e PTK, Z. Johansen ka komunikuar rregullisht me inxhinierët e PTK, R. R.s dhe AKM/ KTA.*

*Më vonë në faqen 29 të procesverbalit, duke u përgjegjës pyetjes së kryetarit të trupit gjykues ajo shtoi:*

*Kryetari i Trupit Gjykses: Trupi gjykues ka dy pyetje. Pra ju na keni thënë se ju e keni takuar Ove Johansen tre herë përpara nënshkrimit të MM dhe ndonjëherë pas nënshkrimit, a und të jeni e saktë se sa herë pas kësaj?*

*L Xh: Nuk më kujtohet ndoshta dy herë, jo më tepër se tre.*

*Kryetari i Trupit Gjykses: A ka qenë Ove Johansen së bashkë me Mustafa Neziri dhe Ronny Sorensen?*

*L Xh: Ai nuk ka qenë kurrë vetëm, gjithmonë me dy ose tre njerëz.*

*Kryetari i Trupit Gjykses: A ka qenë ai person udhëheqës, Z. Ove Johansen?*

*L. Xh.: Po”.*

<sup>32</sup> Deklaratat e N. lidhur me cilësinë e Ove Johansen japin një pasqyrë të mirë të brendshme të Company Norway Invest, dhe janë të rëndësime në konsiderimin e rolit të N. dhe bashkëpunimit të tij të përditshëm me të pandehurin. Deklaratat vijuese janë relevante, marr nga faqja 7 e procesverbalit të 29.4.2010:

*Prokurori Publik: Lidhur me kontratat e juaja, kur i keni nënshkruar kontratat me Norway Invest R&O AS, me kë keni pasur negociata?*

*M. N.: Me Ronny Sorensen dhe Ove Johansen.*

*Prokurori Publik: Me që të dy?*

*M. N.: Kur kemi biseduar për atë ata kanë qenë të pranishëm, por kur e kam nënshkruar ka qenë me Ove Johansen: dhe një inxhinier.*

*Prokurori Publik: Kush ka udhëhequr në negociata?*

*M. N: Kjo është ajo që unë mundohesha të ju tregojë, në fillim unë kam kërkuar prej tyre për 2 javë që të mendoj për këtë punë, pasi që kam pasur punën në atë kohë, dhe unë kam dashur të di se çka do të bëj..*

*Kryetari i Trupit Gjykses: Pyetja ishte e thjeshtë, kush ka udhëhequr negociata nga ana e Norway Invest R&O AS, a kanë qenë të dytë, ose më tepër R. S. ose më tepër Ove Johansen?*

*M. N: Në fillim kur ne filluam negociatat ata të dy kanë qenë të pranishëm, ndoshta R. S. ka qenë pak më tepër përpara, por pastaj ai shkoi në Norvegji. Ai ka qenë personi kryesor.*

*Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që e keni nënshkruar kontratën, gjatë pjesëmarrjes së juaj në negociata me Norway Invest R&O AS, kush ka udhëhequr?*

*M. N.: Personi i dytë përgjegjës ka qenë Ove Johansen.*

pandehuri R. S. ka bërë deklaratat të cilat vërtetojnë konkluzionin e sipërm (edhe pse përpara trupit gjykues S. ka qenë qartë i disponuar të tentojë mos të ekspozojë të bashkëpandehurin, ndërsa përpara hetuesve ai nuk ka pasur këto lloje të skrupullave<sup>33</sup>). Vërtetë, R. S. u ekzaminua më 28 qershor 2010 nëpërmes të ndihmës ligjore ndërkombëtare (të bërë në mënyrë të rregullt nëpërmes të Ministrisë së Drejtësisë dhe në vazhdim nëpërmes të kanalit diplomatik), të kryer nëpërmes të video konferencës me Gjykatën e Oslos në Norvegji, në praninë e Gjykatësit kompetent të Norvegjisë.

Ronnie Sorensen u ekzaminua gjithashtu gjatë hetimeve dhe u ballafaqua gjerësisht, gjatë shqyrtimit kryesor, me deklaratat që ai ka dhënë gjatë fazës së mëparshme.

Lidhur me rolin dhe autorizimet e Ove Johansen, ai ka deklaruar në mënyrë të konsiderueshme:

- se Ove Johansen ka qenë i përfshirë në negociimin e memorandumit të mirëkuptimit (faqja 16 e procesverbalit);
- se akronimi “ R&O” domethënë “ Ronnie dhe Ove”;
- se Ove Johansen filloi biznesin (procesverbali, faqja 28);
- se Ove Johansen është personi që kishte kontrollin në Kosovë (faqja 29).

---

**Prokurori Publik:** Kur keni qenë i mbikëqyrur, kush ka qenë personi i juaj kontaktues?

**M. N.:** Në Kosovë ka qenë Ove Johansen, kur R. S. ka qenë këtu dihet (bën gjeste me dorë).

**Kryetari i Trupit Gjykoës:** çka mendoni? Ka qenë R. S.?

**M. N.:** Po, ai ka qenë kryesor.

Njëjtë N., pasi që është ballafaquar me trupin gjykues, ka deklaruar (faqja 17 e procesverbalit të 29.4.2010) se Ove Johansen ka qenë Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Norway Invest (pra jo së pakti konsulent, sikur që i pandehuri tenton të pohoj) dhe ka pasur autorizimet e rëndësishme menaxhuese, si në vijim:

**Prokurori Publik Përgjigja ishte** “Unë do ti tërheq të hollat sipas udhëzimeve të Ove Johansen: dhe R.S.. Si pronar i kompanisë R.S. gjithashtu ka pasur të drejtë të tërheq nga hollat nga llogaria bankare. Kanë qenë raste kur Ove Johansen: kryetar i bordit të drejtorëve ka kërkuar nga unë të tërheq ose transferoj të hollat, dhe çdo herë unë kam pyetur R. S. çka të bëj. Ky i fundit më këshillonte gojarisht duke më thënë se Ove Johansen: është kryetar i bordit të drejtorëve dhe prandaj ju duhet të përmbaheni urdhrave të tija, edhe kështu çdo herë kur duhesha të bëja transfero të tilla, unë së pari e pyetsha R. S..”

**Kryetari i Trupit Gjykoës:** Atë që i thatë policisë, a e konfirmoni tani? Atë se kjo ka ndodhë gjatë punës së juaj me Norway Invest. A është kjo e saktë?

**M. N.:** 98% po. Aty thotë Ove Johansen dhe R. S.. Por për çdo kërkesë e bërë nga Ove Johansen unë duhej ta merrja aprovimin nga R. S..

**Kryetari i Trupit Gjykoës:** A është e vërtetë se R. S. ju ka thënë se çdo gjë që ju ka urdhëruar ju duhej ta bëni atë?

**M. N.:** Po.

Gjithashtu lidhur me vendimet se si dhe ku të alokohen fondet e Norway Invest, dëshmitari përsëri ka thënë nëse në praktikë kompania ka pasur menaxhim të dyfishtë, të përbërë nga S. dhe Johansen:

**M. N.:** Të gjitha të hollat kanë qenë të administruara dhe të shpenzuara ashtu si më kanë thënë bosët e mi.

**Prokurori Publik Emri i bosëve të juaj?**

**Kryetari i Trupit Gjykoës:** Ai veç u përgjigj. R. S. dhe Ove Johansen.

---

<sup>33</sup> Vërtetë, përpara hetuesve Sorensen ka bërë deklaratat mjaft të mprehta kundër Johansen, me tentim të qartë që të shkarkohet përgjegjësitë e veta: p.sh. “Së bashku me M. N., ai ka qenë personi që aktualisht ka kontrolluar biznesin”, “Ove Johansen ka qenë i përfshirë në aranzhimin e çdo gjëje që kishte lidhje me krijimin e Company Norway Invest”

R. S. ka deklaruar se ai (dhe jo Ove Johansen) ka qenë Drejtor Ekzekutiv i Company Norway Invest. Përkundër kësaj, sikur që u sqarua më lartë, ekzistojnë dokumentet e nënshkuara personalisht nga Ove Johansen, të cilat tregojnë se ai (dhe jo R. S.) ishte Drejtor Ekzekutiv, ose së paku se ai ka vepruar sikur të ishte Drejtor Ekzekutiv, deri në shkallën e nënshkrimit të dokumenteve zyrtare në kornizat e procesverbaleve me synim të implementimit të thelbit të biznesit të kompanisë (që është formimi i ARTET).

Mund të arrihet një konkluzion nga kjo: edhe sikur formalisht Ove Johansen nuk ishte Drejtor Ekzekutiv i kompanisë, me siguri se në disa raste ai ka vepruar si i tillë.

Në tërësi, deklaratat e dëshmitarëve të marra nga një, dhe shumë më tepër nëse konsiderohen së bashku, çojnë deri te konkluzioni se pozita e Ove Johansen ishte e kontrollit thelbësor mbi kompaninë në Kosovë. Fakti se formalisht ai nuk ka pasur një autorizim të tillë nuk e ka penguar që të nënshkruaj kontratën e punësimit të drejtorit menaxhues dhe nuk e ka penguar që të veprojë në operacionet e përditshme si de fakto menaxher. Dhe sidoqoftë sinergia në mes të Ove Johansen dhe R. S. e cila ngrihet nga dëshmitë reflekton në mënyrë perfekte sinergjinë e cila ka qenë e qartë me fillimin e kompanisë në Norvegji që e presenton me emrin e kompanisë “R&O”.

5.4. Nuk është e vërtetë se i pandehuri (sikur që ai mendohej të pohonte gjatë ekzaminimit të tij më 6 korrik 2010<sup>34</sup>) ka dhënë dorëheqje nga çdo përgjegjësi brenda Norway Invest që nga dhjetori 2002, për të u zëvendësuar *in toto* nga Z. P. B.. Përkundrazi, deklaratat e dëshmitarit M. N. dhe dokumentet që gjenden në dosjen e lëndës vërtetojnë se Ove Johansen ka qenë ende *de facto* shumë i pranishëm në jetën e Norway Invest. I njëjti i pandehur e ka kundërshtuar vetveten kur ai (duke u munduar të justifikojë transferimet e të hollave të prillit 2003) ka deklaruar se në atë kohë ai ka punuar për Norway Invest në Beograd.

Mustafë Neziri ka deklaruar se urdhrat për të holla që ai i ka bërë në llogaritë bankare të Norway Invest Belgrade (një kompani e cila përzihet me personin e Ove Johansen) janë bërë sipas urdhrat të bosëve të tij, Ove Johansen dhe R. S. (fjala e fundit ka qenë e R.S). Përpos kësaj, M. N. ka deklaruar se R. S. ka urdhëruar atij të përmbahet udhëzimeve të Ove

---

<sup>34</sup> Shiko procesverbalin e 6.7.2010, faqja 8: “Ove Johansen: .... *Arsyeja pse kam fituar këto 9 muaj në burg ka qenë sepse librat nuk kanë qenë të përfunduara për vitin e fundit kur ne kemi falimentuar. Kjo është pse unë nuk isha në Kosovë në 2003 pak a shumë sepse unë e kam vuajtur dënimin; unë kam një gjë për ti thënë prokurorit.*

**Kryetari i Trupit Gjykses:** *Ky është momenti për pyetje, ju do të keni kohë për deklarata më vonë.*  
**Ove Johansen:** *Unë kam pasur këtë dënim në nëntor 2002 dhe unë menjëherë iu thash atyre që kontrollonin Norway Invest Në Norvegji, se e lë punën, kështu që mos të jetë problem për Norway Invest R & O AS kështu që ata e morën një projekt menaxher të ri në nëntor 2002 të quajtur P. B”.*

Johansen. Dy rrethana tjera veç e kanë theksuar kundërthënien e deklaratave të pandehurit, p.sh.:

- procesverbali i mbledhjeve të 6 shkurtit 2003 nënshkruar nga Ove Johansen si Drejtor Ekzekutiv i Norway Invest;
- shkëmbimi i e-mailit të 27 shkurtit 2003 me R. R. dhe L. Xh.

Kjo domethënë se fakti që një teknik i ri (P. B.) u paraqit në jetën e Norway Invest si (pretendohet) menaxher i projektit (gjithashtu lidhur me atë se vet i pandehuri ka pranuar se kompetencat e tija teknike në këtë fushë nuk ishin më të larta se të një personi të rëndomtë<sup>35</sup>) nuk domethënë se prania e shquar e Ove Johansen ka ndërprerë të ekzistojë. Dhe, në fund, sikur të ishte e vërtetë se Ove Johansen nuk ka luajtur kurrfarë roli në kompani që nga marsi 2003, atëherë kishte me qenë e pamundur që ai të materializojë ligjshmërinë e pagesave që ai ka pranuar në mars/prill në llogaritë e tija në Beograd (kinse në emër të Norway Invest).

5.5. Ove Johansen ka qenë në dijeni se pagesa e 300.000 Euro nga PTK në Norway Invest nuk ka qenë e nevojshme.

I pandehuri mbronte veten duke deklaruar:

- se ai nuk ka mundur të dinte (duke qenë i jashtëm për PTK) se Leme Xhema nuk ka qenë e autorizuar që të urdhëroj pagesën;
- se Norway Invest ka kryer aktivitetet në favor të PTK;
- se prandaj këto aktivitete kanë qenë për të u faturuar dhe paguar.

Ky konkluzion nuk mund të ndahet, për shkak të arsyeve vijuese:

- a. Ove Johansen nuk ka mundur të injoronte se kushti i PTK që të pajtohet me shpenzime ishte ekzistimi i një marrëveshjeje obliguese në mes të PTK dhe Norway Invest. Është një parim bazik, që edhe operatori më së paku i përgatitur në këtë fushë e din, se ligji ndalon kompanitë publike që të paguajnë shumat e të hollave pa një obligim ligjor mbi mbështetjen e pagesës. Është e rëndësishme të vërehet se Ove Johansen ka pohuar se ishte një operator ekspert ndërkombëtar në këtë fushë<sup>36</sup>. Dhe është e rëndësishme të shtohet se pagesa të cilën Norway Invest ka kërkuar nga PTK ka qenë për

<sup>35</sup> Shiko procesverbalin e gjykimit të 6.7.2010, faqja 7:

*“Prokurori Publik: Kjo domethënë se ju nuk keni kualifikime në fushën e IT?”*

*Ove Johansen: Jo, jo më tepër se një njeri normal”.*

<sup>36</sup> faqja 6 e procesverbalit të gjykimit të 6.7.2010:

*Ove Johansen: Arsimimi im është si inxhinier, unë kam udhëhequr projektet diçka si përafërsisht 1000 prej tyre, që përfshin sistemet e emergjencës kryesisht të kompanive multinacionale dhe kompanitë e sigurimeve nëpër gjithë botën. Unë kam udhëhequr projektet në Australi, Kinë Francë Gjermani, BM, SHBA dhe ndoshta 20 shtete tjera. Unë kam pasur të gjitha aprovimet sipas Normave të Evropës Qendrore. Unë kam qenë i vetmi së paku në Evropën veriore që pasur të gjitha aprovime. Normalisht unë kam udhëhequr rreth 100 inxhinierë në këto projekte.*

shërbimet të cilat ende pohohej se duhej të kryheshin nga Norway Invest. Kjo, duke e konsideruar faktin se PTK ka qenë një ndërmarrje publike shoqërore, është sidomos befasuese.

- b. Ove Johansen ka ditur se në rastin konkret një marrëveshje e tillë nuk ka ekzistuar. Mbetet së paku një pretendim i tij se nuk ekzistonte një marrëveshje sipas të cilës PTK duhej të pajtohej lidhur me shpenzimet e bëra nga Norway Invest. Dhe ligji është i qartë (sikur që është theksuar edhe në Aktgjykimin e Dhomës Speciale) në atë se vetëm një marrëveshje me shkrim (dhe atë e detajizuar, sipas kërkesave të definuara në seksionin 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut mbi Organizimet e Biznesit) kishte me qenë obliguese për PTK.
- c. Ove Johansen gjatë mbrojtjes së tij kurrë nuk ka qenë në gjendje të tregojë saktësisht burimet e obligimit ligjor për PTK se pajtohet me shpenzimet. I pandehuri gjatë ekzaminimit të tij ndonjëherë u referua memorandumit të mirëkuptimit, e ndonjëherë tjetër ka deklaruar se ishte nënkuptuar në mes të palëve që në fillim se do të jetë kontribumi në shpenzime 50/50. Por ai nuk ka qenë në gjendje që të tregojë dokumentet e sakta se ku është thënë kjo.
- d. Shuma e shpenzimeve të pretenduara që kishin të drejt të kompensoheshin për projektin TETRA ka qenë shumë më e vogël sesa ajo e treguar në faturë (dhe kjo me siguri ka qenë evidente për Ove Johansen, duke e pasur rolin dhe kapacitetin e tij në kompani);

**5.6. Duke vepruar si menaxher i Norway Invest, ai ka qenë personi që kryesisht ka shtyrë përfundimin e marrëveshjes së aksionarëve për krijimin e Kompanisë së Përbashkët/ Joint Company. Kjo, përkundër pohimeve kundërthënëse të pandehurit, ngrihet nga provat që gjenden në dosjen e lëndës. Përpos procesverbalit të mbledhjes dhe shkëmbimeve të e-mailit gjerë në mars 2003 veç të ekzaminuar më lartë, i pandehuri është ai që tentonte deri në fund (nëpërmes të krijimit të kompanive që vazhdonin në Company Norway Invest) të bëjnë një marrëveshje me PTK ose së paku të kthejnë (një pjesë) ë humbjes së Norway Invest. Gjithashtu veç është sqaruar se Ove Johansen ka qenë plotësisht në dijeni të identitetit dhe rolit të Leme Xhemës brenda PTK, si dhe të autorizimeve të saja në cilësi të drejtoreshës menaxhuese.**

Duke pasur parasysh atë që është thënë më lartë, Trupi Gjykses pajtohet se Ove Johansen, në pozitën e tij faktike të menaxherit të Norway Invest, ka kërkuar pagesën e shumës së papaguar të 300.000 EUR. Kjo është, para së gjithash, e dukshme së paku në kuptim të logjikshëm, duke pasur:

- Pozitën e tij e shquar në Norway Invest;

- Rëndësia e veçantë e pagesës: kjo nuk ishte vetëm posaçërisht relevante: gjithashtu do të nënkuptonte konfirmimin se marrëveshja në mes të Norway Invest dhe PTK ishte kryer.

Kjo gjithashtu është e bërë e qartë nga fakti se Ove Johansen ka qenë prapa procesit të faturimit të pagesës së tillë (shiko shkëmbimin e e-mailit veç të përmendur të 27/2 – 3/3/2003 në të cilin R. R. udhëzon personat e përfshirë – Ove Johansen dhe L. Xh. – mbi atë se si të organizojnë faturimin me qëllim që pagesa të kompletohet formalisht).

Kjo e sipërme përfshinë që jo vetëm Ove Johansen ka dhënë shkakun e pagesës: ai gjithashtu ka mundësuar palën tjetër L. Xh. që të ketë justifikimin dokumentues të kësaj.

Gjithashtu ekzistojnë prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës se menaxhmenti i Norway Invest ka qenë në dijeni të mirë mbi mungesën e një baze ligjore bindëse për pagesë (dhe kështu nuk ekzistonte një kredit i Norway Invest ndaj PTK) dhe tentoi të eskivojë dokumentimin me qëllim që t'i shmanget vështirësitë së tillë ligjore: kjo është bërë e qartë me faktin që rreth një muaj pas lëshimit të faturës së parë nga Norway Invest për PTK, një faturë identike (por në mënyrë fiktive e lëshuar nga kompania jo ekzistuese ARTET) ishte lëshuar PTK-ës për të njëjtin borxh. Kjo mund të gjej shpjegimin logjik vetëm duke pranuar se menaxhmenti i Norway Invest dhe menaxhmenti i PTK janë munduar të japin një arsytim të besueshëm për pagesën e paligjshme, duke e pasur të qartë të dyja se, në bazë të marrëveshjeve që kanë qenë të hartuara, vetëm ARTET (*pasi krijohet*) do të kishte të drejtë të merr kontribute financiare nga PTK dhe kështu vetëm ARTET do të kishte lëshuar faturat e ligjshme në PTK.

Vlen që të shtohet se Norway Invest/Ove Johansen kanë pasur një interes shumë të fortë në marrjen e pagesës. Interesi i tillë ka qenë i natyrës së dyfishtë. Së pari, do të kishte kuptimin e oksigjenit për kompaninë. E dyta, do të kishte përforcuar pozitën e Norway Invest ndaj PTK gjatë negociatave, duke sjellë një hap tjetër faktik në rrugën kah bëra e kontratës të një marrëdhënie kontraktuese. Interesi i madh i Norway Invest është lehtë të verifikohet duke shikuar në shumën e të ardhurave që janë pritur në rast se bëhet kontrata: pohimi kundër PTK/KTA i cituar në Aktgjykim të Dhomës Speciale të Gjykatës Supreme tregon shumën prej 11.700.000 EUR për humbje të kontratës.

Lidhur me atë më lart duhet të konkludohet se Ove Johansen me vullnet ka kontribuar në sjelljen e Leme Xhemës kur ajo ka urdhëruar pagesën e 300.000 Euro prej PTK në Norway Invest.

Dy pohime faktike gjenden në aktakuzën të cilat nuk kanë qenë të vërtetuara mjaftueshëm gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor.

a. Ndjekja pretendonte se Ove Johansen ka pasur avantazh personale financiare nga kjo pagesë.

Ekzistojnë në dosjen e lëndës, vërtetë, aluzionet e forta në atë drejtim.

Është vërtetuar, në fakt se pasi që pagesën e PTK-ës ka pranuar Norway Invest në llogari me dy urdhra për të holla në shumë të përgjithshme prej 250.000 EUR janë bërë nga Mustafa Neziri për llogarinë bankare të Norway Invest Beograd, ku personi i autorizuar për operim ka qenë Ove Johansen.

Trupi Gjykses vëren se, pasi që të hollat janë paguar Norway Invest-it dhe para se Mustafa Neziri ka urdhëruar pagesat për Ove Johansen, shumat tjera të mëdha të hollave kanë qenë të pranuar nga Norway Invest prej Norvegjisë. Ekziston dyshimi i arsyeshëm, prandaj, se të hollat që kanë qenë të dërguara për Ove Johansen aktualisht vinin prej Norvegjisë.

**b.** Ndjekja ka pretenduar se krijimi i vet Norway Invest nuk ka pasur substancë reale dhe së paku ka pasur qëllimin të mashtrijë PTK për 300.000 EUR. Gjithashtu në këtë rast ekziston dyshimi serioz në atë drejtim (përbëhet në faktin se Norway Invest nuk ka pasur një skelet të fortë financiar, në faktin që kapacitetet teknike të kompanisë dhe të Ove Johansen kanë mbetur të turbullta, se nuk ekzistonte qartësia lidhur me natyrën dhe shumën e shpenzimeve të bëra nga Norway Invest në Kosovë). Në anën tjetër, është dhënë se Norway Invest aktualisht ka investuar shumat e rëndësishme së caktuar në Kosovës (së paku lidhur me qiramarrjen e objektit në Pejton dhe lidhur me rekrutimin e disa të punësuarve). Kjo paraqet një dyshim të arsyeshëm lidhur me pohimet e Prokurorit, duke qenë e mundur të argumentohet (si një rekonstrukcion alternativ) se aktualisht një investim ishte bërë dhe ky nuk ka dalë të ishte i suksesshëm.

Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë, se i pandehuri nuk ka kontribuar në shpërdorimin e pozitës zyrtare të kryer nga L. Xh.: më lartë ishte theksuar se elementet përbërëse të veprës penale mbesin plotësisht të vërtetuara.

## 6. Dënimi

Sipas nenit. 34 të KPK, qëllimet e dënimit janë që kryesi të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe kryesi të rehabilitohet; dhe personat tjerë të largohen nga kryerja e veprave penale.

Kur të llogaritet dënimin Trupi Gjykses do të llogaritet *inter alia* shkallën e përgjegjësisë penale, motivin për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikut ose lëndimet e vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat vepra është kryer, sjellja e kryesit në të kaluarën, dhënia e deklaratës mbi fajësinë, rrethanat personale të kryesit dhe sjellja e tij/ saj pas kryerjes së veprës penale.

Në rastin konkret Trupi Gjykses ka marr në konsideratë si rrethana rënduese shumën e madhe të hollave të cilat kanë qenë objekt i pagesës, dhe në vazhdim dëmi i madh i

shkaktuar buxhetit të PTK. Duhet, përpos kësaj, të konsiderohet se i pandehuri veç ka qenë i dënuar në Norvegji për shkak të veprës penale të kontabilitetit të rrejshëm dhe të kundërvajtjes (të lidhur me qarkullimin rrugor).

Si rrethana lehtësuese (që duhet të vlerësohen lidhur me nenin 44, paragrafin 1, në lidhje me nenin 66, KPK) Trupi Gjykses konsideron faktin që i pandehuri, ndryshe nga bashkë-kryesja Leme Xhema, nuk ka pasur ndonjë pozitë zyrtare: kjo e bën pozitën e tij më të lehtë nëse krahasohet me këtë të fundit, e cila si një person zyrtar ka qenë e përballur – nga pikëvështrimi subjektiv dhe objektiv – me një standard më të lart të zellit dhe besueshmërisë gjatë punës me autorizimet publike të besuara asaj.

Një rrethanë tjetër lehtësuese të cilën trupi gjykses e ka konsideruar është fakti se nuk ekziston provë e plotë se të hollat e paguara nga PTK kanë përfunduar në xhepat e Ove Johansen. Kështu, ekziston vetëm prova për faktin se veprimet e të pandehurit kanë çuar deri te pasurimi i Norway Invest dhe se motivi i Ove Johansen për pranimin e pagesës së paligjshme mund të ketë qenë një zell i tepërt në ndjekjen e synimeve të Norway Invest.

Gjithashtu vështirësitë që lidhen me kryerjen e biznesit në Kosovë në kohën kur i pandehuri ka vepruar duhet të konsiderohen (me një qasje *in dubio pro reo*) në favor të pandehurit.

Në fund, Trupi Gjykses ka konsideruar se i pandehuri tashmë ka qenë në paraburgim dhe paraburgim të para-ekstradimit për më tepër se një vjet, për fazën e konfirmimit dhe për shqyrtimin kryesor. Duke konsideruar me kujdes rrethanat e sipërme, i pandehuri kështu dënohet me burgim prej dy vitesh.

Trupi Gjykses mendon se ekzistojnë kushtet për dënim me kusht, ku mund të konkludohet se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe pa kryer ekzekutimin e tij.

Dënimi prandaj do të ekzekutohet nëse brenda periudhës kohore prej dy viteve duke filluar nga data kur Aktgjykimi bëhet fuqiptotë Ove Johansen nuk e kompenson dëmin e shkaktuar PTK-ës në shumë prej 300.000 Euro

Kjo duke marr parasysh:


- Faktin se një pjesë e madhe e dënimit veç është kryer;
- Kushtin e rëndë (kompensimi i dëmit prej 300.000 Euro) të bashkangjitur dënimit me kusht.

Prandaj është vendosur si në dispozitiv.

Prishtinë, 9.7.2010

Kryetari i Trupit Gjykses

Ferdinando Buañer de Mongeot



Anëtar i Trupit Gjykses

Francesco Florit

Anëtar i Trupit Gjykses

Nehat Idrizi

Procesmbajtësja

Christin Nilsson